




REALIZIM I MËSIMIT NGA EDUKATA QYTETARE NË SHKOLLAT FILLORE

RAPORT NGA
HULUMTIMI





**REALIZIM
I MËSIMIT NGA
EDUKATA
QYTETARE NË
SHKOLLAT
FILLORE**

RAPORT NGA
HULUMTIMI



QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR



Byroja për zhvillim të arsimit

Pestalozzi Children's Foundation

Education and intercultural competence – worldwide



Ky raport është përgatitur nga ana e Projektit Forcimi i bashkëpunimit multi-etnik në komuna, me mbështetje të Fondacionit të Fëmijëve Pestalocci, i realizuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Byronë për Zhvillim të Arsimit (BZHA).

Raporti është përgatitur nga grupi i punës i përbërë prej përfaqësuesve të: Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, inspektor zyrtar komunal, si dhe ekspertë në fushën e arsimit.

Qëndrimet e shprehura në këtë dokument ju takojnë autorëve dhe nuk paraqesin pikëpamjet e Fondacionit të Fëmijëve Pestalocci.

Titulli:

REALIZIMI I MËSIMIT NGA EDUKATA QYTETARE NË SHKOLLAT FILLORE
raport nga hulumtimi

Botues:

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ)

Raportin e përgatitën:

Mr. Gorica Mickovska
Mr. Mitko Çeshllarov
Mr. Ana Mickovska Raleva

Hulumtimin në terren e realizuan:

Ajshe Ajrullai
Mr. Zhaneta Çonteva
Zoran Uzunov

Redaktim profesional:

Mr. Loreta Georgieva
Besnik Ramadani
Mr. Anica Aleksova

Përkthimi:

Enis Misini

Dizajni:

KOMA

Shtypshkronja:

Vinsent Grafika

Tirazhi:

80

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3:37.035(497.7)(047)

MICKOVSKA, Gorica

Realizim i mësimit nga edukata qytetare në shkollat fillore :
raport nga hulumtimi / [raportin e përgatitën Gorica Mickovska, Mitko
Çeshllarov, . Ana Mickovska Raleva]. - Shkup : Qendra maqedonase për
edukim qytetar (QMEQ), 2016. - 56 str. : tabeli ; 30 cm

Публикацијата е во рамки на проектот: " Forcimi i bashkëpunimit
multi-etnik në komuna". - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-4529-61-3


1. Çeshllarov, Mitko [автор] 2. Mickovska Raleva, Ana [автор]
а) Граѓанско образование - Основни училишта - Македонија - Извештаи
COBISS.MK-ID 102283530

PËRMBAJTJA

REZYME E PËRGJITHSHME	5
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	11
1. INFORMACIONE THEMELORE PËR PROJEKTIN	13
2. KORNIZË KONCEPTUESE PËR HULUMTIMIN	15
3. METODA DHE INSTRUMENTE PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE	17
4. EKZEMPLAR	18
5. MBLEDHJE, PËRPUNIM DHE ANALIZË E TË DHËNAVE	20
REZULTATE	21
1. PERCEPTIM PËR PROGRAMET MËSIMORE	23
2. PERCEPTIME PËR REALIZIMIN E MËSIMIT	31
3. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E LIBRAVE SHKOLLOR	37
4. PERCEPTIME PËR TRAJNIMET	41
5. PERCEPTIME PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE TË MËSIMIT	43
SHTOJCA	46

FALËNDERIM

të gjithë bashkëpunëtorëve që ishin të përfshirë në procesin e realizimit të këtij hulumtimi, veçanërisht nxënësve dhe arsimtarëve që u përgjigjën në pyetësonin elektronik dhe që morën pjesë në diskutimet e fokus grupeve.



REZYME E PËRGJITHSHME

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit ishte që të përcaktohet gjendja aktuale sa i përket planifikimit dhe realizimit të mësimit nga lënda Edukatë qytetare në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë, me qëllim që të përkufizohen drejtimet konkrete për përmirësimin e cilësisë së procesit të nxënies dhe mësimeve në orët e Edukatës qytetare.

Hulumtimi është i orientuar, para së gjithash, drejt dhënies së përgjigjes në pyetjet vijuese:

- ➔ Cilat janë mendimet e nxënësve dhe arsimtarëve për programet nga lënda Edukatë qytetare?
- ➔ Si realizohet mësimi dhe nxënia nga lënda Edukatë qytetare?
- ➔ Cilat janë mendimet lidhur me librat shkollor nga lënda Edukatë qytetare?
- ➔ Çfarë trajnimesh u nevojiten arsimtarëve që ligjërojnë lëndën Edukatë qytetare?

ZBATIMI I HULUMTIMIT

Mendimet për realizimin e mësimit dhe nxënies nga lënda Edukatë qytetare janë mbledhur nga arsimtarë që e ligjërojnë lëndën dhe prej nxënësve që e kanë mësuar atë. Përmes pyetësorit elektronik janë marrë përgjigje prej 241 arsimtarëve të 178 shkollave fillore dhe prej 542 nxënësve të klasës së tetë dhe nëntë të 44 shkollave fillore¹. Krahas kësaj, të dhëna më cilësore për realizimin e programeve dhe arsytimit më të hollësishme janë marrë përmes diskutimeve në fokus grupe: 4 fokus grupe me 42 arsimtarë dhe 5 fokus grupe me gjithsej 56 nxënës.

Hulumtimi është zbatuar në maj dhe në qershor të vitit 2016. Anketimin e nxënësve në terren e organizuan këshilltarë të Byrosë për Zhvillim të Arsimit nga Shkupi dhe Tetova dhe inspektori komunal i arsimit nga Komuna e Strumicës, të cilët i drejtonin edhe diskutimet në fokus grupet.

¹ Shkollat janë nga të gjitha rajonet e Republikës së Maqedonisë (shiko: Shtojca 1 dhe Shtojca 2). 17% e arsimtarëve të anketuar japin mësime në gjuhën shqipe, ndërsa 83% në gjuhët tjera mësimore (maqedonisht, turqisht, serbisht). 68% e nxënësve të anketuar mësojnë në gjuhën mësimore maqedonase, ndërsa 32% në gjuhën shqipe.

Të dhënat e mbledhura janë grupuar dhe analizuar në përputhje me pyetjet të cilave hulumtimi kishte për qëllim t'u përgjigjet.

TË DHËNA THEMELORE NGA HULUMTIMI

1. MENDIME PËR PROGRAMET NGA LËNDA E EDUKATËS QYTETARE

- ➔ Sipas nxënësve, edukata qytetare duhet të mësohet për shkak se përmbajtjet nga edukata qytetare u janë të dobishme në jetë. Pjesën më të madhe të përmbajtjeve i konsiderojnë të rëndësishme (mbi 70% e nxënësve i konsiderojnë të rëndësishme 6 prej 7 temave) dhe interesante (4 prej 7 temave u janë interesante mbi 70% të nxënësve). Më interesante u janë përmbajtjet për të drejtat e njeriut, ndërsa më së paku interesante ato për pushtetin dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Ata konsiderojnë se disa nga temat që nuk u janë interesante janë të rëndësishme për t'i mësuar.
- ➔ Numri më i madh i arsimtarëve (mbi 70%) konsiderojnë se të gjitha temat janë të rëndësishme dhe se nxënësit i konsiderojnë të rëndësishme. Për më të rëndësishme se të tjerat i konsiderojnë: Të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut, Demokracinë dhe shoqërinë civile, Konfliktin dhe Mediat. Po aq numër i arsimtarëve (70%) konsiderojnë se këto tema, nëse merren në përgjithësi, janë interesante edhe për nxënësit. Më së paku e rëndësishme dhe më së paku interesante, sipas tyre, është tema: E drejta ndërkombëtare humanitare.
- ➔ Perceptimi i arsimtarëve për atë se sa janë të rëndësishme dhe interesante disa përmbajtje të caktuara në programet mësimore, është më pozitiv sesa perceptimi i nxënësve. Një numër i vogël i arsimtarëve (18%) dhe nxënësve (19%) kanë propozim për përmbajtje të reja në programin. Tre të katërtat e arsimtarëve konsiderojnë se një orë nuk mjafton për realizimin e përmbajtjeve.
- ➔ Emri i lëndës edhe sipas arsimtarëve edhe sipas nxënësve është adekuat me përmbajtjet.

2. METODA PËR REALIZIMIN E MËSIMIT DHE MBËSHTETJE TË NXËNIES

- ➔ Programi mësimor rekomandon përdorimin e metodave të ndryshme ndërvepruese. Sipas përgjigjeve të nxënësve dhe arsimtarëve, mësimi është i llojllojshëm në aspektin metodik, ndonëse në të shumtën e rasteve përdoren metoda e monologut dhe tekst metoda. Megjithatë, nxënësit janë përgjigjur se arsimtarët, ndryshe nga ajo që kanë informuar, më rrallë i përdorin metodat aktive.
- ➔ Numrit më të madh të nxënësve (60%), orët e edukatës qytetare u janë gjithmonë interesante. Kur i kanë radhitur metodat e nxënies që më së shumti i preferojnë, ata i kanë radhitur më së miri ato që edhe në të shumtën e rasteve i përdorin në mësim: ligjërata dhe punë në grupe. Kjo tregon se nxënësit nuk janë të përgatitur sa duhet për nxënie aktive gjatë mëimit.
- ➔ Mbështetja e nxënies së nxënësve përmes sqarimit të përmbajtjeve dhe kuptimeve, sipas arsimtarëve, është e rregullt dhe e shpeshtë, por sipas nxënësve nuk është mjaftë e rregullt, veçanërisht në orët e radhës.
- ➔ Numri më i madh (75%) i nxënësve kanë ndjenjën se arsimtarët i nxisin vazhdimisht për pjesëmarrje aktive, ndërsa të tjerët konsiderojnë se kjo ndodhë ndonjëherë.
- ➔ Të ndryshme janë perceptimet e arsimtarëve dhe të nxënësve për atë nëse gjithmonë mund ta shprehin lirshëm mendimin, pa qenë të kritikuar. 78% e arsimtarëve konsiderojnë se këtë e mundësojnë gjithmonë, përderisa 57% e nxënësve kanë ndjenjën e tillë.
- ➔ 57% e arsimtarëve nuk i informojnë prindërit për punën në orët e edukatës qytetare dhe nuk i nxisin që të përfshihen në njëfarë mënyre.
- ➔ 25% e nxënësve kanë deklaruar se nuk marrin shumë shpesh informacion përkatës kthyes që do t'i udhëzonte se si të përmirësojnë nxënien, ndërsa instrumentet për notim që janë përdorur në të shumtën e rasteve janë parashtrimi i pyetjeve me gojë dhe mbajtja e shënimeve.

3. MENDIME PËR LIBRAT SHKOLLOR

- ➔ Në mësimin e Edukatës qytetare, librat shkollor përdoren rregullisht në orë, ndërsa kohë pas kohë bashkë me librat shkollor përdoren edhe materiale plotësuese.
- ➔ 61% e arsimtarëve konsiderojnë se librat shkollor u ndihmojnë nxënësve që t'i sqarojnë dhe mësojnë përmbajtjet dhe kuptimet nga programi mësimor, por pjesa tjetër prej 39% konsiderojnë se nuk u ndihmojnë. Ata bëjnë të ditur se struktura dhe përmbajtja e librave shkollor e kufizon realizimin e të gjitha qëllimeve nga programi mësimor.
- ➔ 40% e arsimtarëve konsiderojnë se në librat shkollor një pjesë e temave dhe kuptimeve/përkufizimeve janë të vjetruara, problematike ose konfuze.
- ➔ Thuajse gjysma (47%) e nxënësve konsiderojnë se libri shkollor nuk u ndihmon sa duhet në sqarimin dhe mësimin e përmbajtjeve dhe kuptimeve që përpunohen në orë, ndërsa 22% konsiderojnë se në to ka tema, përmbajtje, kuptime, ilustrime që nuk janë përkatëse ose janë paraqitur në mënyrë të gabuar.
- ➔ Arsimtarët në praktikë përdorin dhe kanë nevojë për materiale plotësuese, duke përfshirë: doracakë për realizimin e përmbajtjeve mësimore, linqe me përmbajtje nga interneti, materiale vizuale.

4. TRAJNIME PËR REALIZIMIN E EDUKATËS QYTETARE

- ➔ Gjatë pesë viteve të kaluara 56% e arsimtarëve nuk kanë ndjekur trajnim që ka të bëjë me lëndën Edukatë qytetare. Rreth 53% e arsimtarëve që japin Edukatë qytetare nuk janë adekuat sipas normativit të kuadrit mësimor, prej çka rezulton se u janë të domosdoshme trajnime për përmbytjet.
- ➔ Shumica e arsimtarëve duan trajnime për përdorimin e metodave ndërvepruese të mësimit, si dhe ushtrime konkrete për realizimin e përmbytjeve nga libri shkollor përmes teknikave bashkëkohore mësimore.
- ➔ Arsimtarëve u nevojiten trajnime për përdorimin e internetit si resurs, trajnime për metoda të notimit dhe rritjen e të arriturave të nxënësve përmes mësimdhënies përkatëse, si dhe trajnime profesionale për përmbytjet mësimore.
- ➔ Arsimtarët përmendin edhe nevojën e bashkëpunimit me kolegët në nivel të aktiveve profesionale, si dhe mbështetje prej këshilltarëve.

5. MENDIME PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE TË EDUKATËS QYTETARE

- ➔ Shumica e arsimtarëve (82%) konsiderojnë se lënda Edukatë qytetare ndihmon numrin më të madh të nxënësve që t'i arrijnë qëllimet e programit mësimor. Mirëpo, 52% e nxënësve janë përgjigjur se lënda Edukatë qytetare u ndihmon shumë që t'i arrijnë qëllimet e mësimit (t'i kuptojnë problemet me të cilat përballet bashkësia në të cilën mësojnë dhe jetojnë, të mendojnë për zgjidhje të problemeve, të përfshihen në aktivitete në bashkësinë lokale), derisa pjesa tjetër prej 48% konsideron se u ndihmon vetëm ndonjëherë.
- ➔ 42% e nxënësve janë përgjigjur se kanë marrë pjesë në punë publike/shoqërore, aktivitete vullnetare në shkollë ose jashtë shkollës që është një nga treguesit për gatishmërinë për angazhim qytetar.
- ➔ Arsimtarët vlerësojnë se nxënësit janë aktiv në bashkësi përmes: pjesëmarrjes në aktivitete jashtëmësimore, përfshirje dhe zgjidhje të problemeve të bashkësisë, si dhe sjellje që bën të ditur në kërkimin e të drejtave.
- ➔ Arsimtarët përballen me vështirësi që t'ua sqarojnë nxënësve mospërputhjen e asaj që mësohet në edukatën qytetare dhe zhvillimet e përditshme politike në shtet me të cilat ndeshen nxënësit.
- ➔ Për pjesën e konsiderueshme të arsimtarëve (49%) aspekt kryesor i mësimit është zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 (mendim kritik, tolerancë, respektim i vlerave demokratike) të nxënësit, ndërsa për një numër diçka më të vogël (25%) edhe përkatësia në shoqëri dhe bashkësi.

REKOMANDIME

PROGRAME MËSIMORE

Koncepti për mësimin e edukatës qytetare duhet të rishikohet dhe të shqyrtohen programet mësimore nga aspekti i përputhjes me përmbajtjet (si p.sh. Media dhe e Drejta ndërkombëtare humanitare) dhe qasjet që përdoren në vendet tjera evropiane, si dhe për shkak të evitimit të përputhjes së përmbajtjeve nga edukata qytetare në programe të ndryshme mësimore dhe jashtëmësimore.

METODA TË REALIZIMIT TË MËSIMIT

Duhet të ulet shpeshtësia e qasjes ligjëruese–lexuese në mësim dhe të rritet shfrytëzimi i metodave ndërvepruese. Qëllimi i mësimit duhet të “demokratizohet” edhe më shumë dhe nxënësit duhet të mësojnë më shumë nga ajo që bëhet, e jo vetëm nga ajo që “ligjërohet” gjatë orëve.

Arsimtarët e nxënësve dhe prindërit (ku kjo nuk është rast) duhet të marrin rregullisht informacion cilësor kthyes që do të kontribuojë në nxënien më cilësore.

LIBRA SHKOLLOR DHE DORACAKË

Librat ekzistues shkollor duhet të rishikohen që të plotësohen me të dhëna aktuale dhe të mënjanojnë të dhënat e pasakta, si dhe përmbajtjet joadekuate dhe konfuzë. Nevojiten të përpilohen doracakë për realizimin e mësimit me shfrytëzimin e metodave ndërvepruese.

TRAJNIME DHE MBËSHTETJE PROFESIONALE

Arsimtarët që nuk janë përkatës për të ligjëruar lëndën edukatë qytetare të jenë të obliguar që të kalojnë trajnim plotësues në kohëzgjatje më të gjatë që do të ndërlidhen si me përmbajtjet, ashtu edhe me metodat e realizimit të tyre.


Të formohen dhe forcohen ekipe rajonale për nxënie të arsimtarëve nga edukata qytetare që do t'i udhëheqin këshilltarë ose arsimtarë të dalluar nga edukata qytetare.

KONTROLL I ARRITJES SË QËLLIMEVE

NGA EDUKATA QYTETARE

Të përpilohen standarde për të arriturat dhe për notim nga lënda edukatë qytetare.

Të gjendet mënyrë adekuate e hulumtimit kombëtar të arritjes së qëllimeve për edukatë qytetare, sesa që është notimi ekzistues ekstern.



METODOLOGJIA E HULUMTIMIT



Në këtë pjesë janë paraqitur informacionet themelore për projektin Forcim i bashkëpunimit shumetnik në komunat si dhe korniza konceptuese për këtë hulumtim. Këtu janë përshkruar metodat dhe instrumentet për mbledhjen e të dhënave, është dhënë përshkrim i popullatës dhe ekzemplari i të anketuarve, duke përfshirë edhe përzgjedhjen e ekzemplarit, si dhe mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave të mbledhura.

1. INFORMACIONE THEMELORE PËR PROJEKTIN

Edukata qytetare është pranuar si mënyrë e mirë që vendet t'i arsimojnë qytetarët për të drejtat dhe përgjegjësitë, për zhvillimin e sistemit të vlerave në të cilin do të respektohen të drejtat e njeriut, e në këtë kontekst edhe të drejtat e fëmijëve, si dhe pranim dhe respektim të diversitetit.

Në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë që nga pavarësia e deri sot janë bërë përpjekje për të gjetur një koncept përkatës për gjetjen e formave dhe përmbajtjeve përkatëse që në kuadër të arsimit fillor do të mundësojnë aftësim përkatës të të rinjve për jetë në shoqërinë civile. Në fillim aktivitete më voluminoze në këtë drejtim ishin projektet *Baza të demokracisë dhe Ne populli – Projekt qytetar*², që rezultuan me vendosjen e përmbajtjeve nga edukata qytetare në lëndën mësimore Shoqëri në mësimin klasor, e më vonë edhe me vendosjen e lëndës Edukatë qytetare në klasën e shtatë dhe të tetë, gjegjësisht klasë të tetë dhe të nëntë të arsimit fillor. Disa nga qëllimet dhe parimet e përgjithshme të shënuara në Koncepticionin për arsim fillor nëntëvjeçar³ mund të realizohen edhe përmes programit *Shkathhtësi jetësore dhe lëndës Etikë*. Një pjesë e qëllimeve realizohen edhe përmes *Projektit të USAID-it për integrim ndëretnik në arsim* dhe projekte tjera me vëllim më të vogël të cilat, në të shumtën e rasteve, janë të orientuara drejt arsimit shumetnik.

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ), përmes Fondacionit për fëmijë Pestaloci, filloi me realizimin e **projektit Forcim i bashkëpunimit shumetnik në komunat** në vitin 2011. Qëllimi kryesor i këtij projekti, me mbështetjen e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, është që në komunat në të cilat jetojnë pjesëtarë të grupeve të ndryshme etnike të planifikohen dhe realizohen aktivitete në shkolla të përzgjedhura shumetnike që do të kontribuojnë në forcimin e tolerancës dhe bashkëpunimit shumetnik dhe ndërkulturor.

2 Këto aktivitete u realizuan gjatë periudhës prej viti 1998 deri në vitin 2004, në kuadër të projektit të USAID-it: Edukata qytetare, rruga drejt shoqërisë civile të implementuar nga CRS në bashkëpunim me MASH-in dhe BZHA-në.

3 Koncepticioni për arsim fillor nëntëvjeçar, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, 2007, Shkup

AKTIVITETET E PROJEKTIT NË PERIUdhËN E KALUAR ISHIN KRYESISHT TË ORIENTUARA DREJT:

- ➔ Trajnimit të arsimtarëve që ligjërojnë edukatë qytetare dhe shoqëri për forcimin e kapaciteteve të tyre për përfshirjen e elementeve nga integrimi ndëretnik në mësim të rregullt
- ➔ Orëve të përbashkëta me nxënës që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme mësimore
- ➔ Zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve/seksione me nxënës të përkatësisë së ndryshme etnike
- ➔ Mbështetjes së arsimtarëve që ligjërojnë Edukatë qytetare dhe Shoqëri nga këshilltarët e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA)
- ➔ Zhvillimit të instrumenteve për ndjekjen e mësimit nga aspekti i integritimit ndëretnik në bashkëpunim me BZHA-në
- ➔ Prezantimit të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve në nivel të shkollës para prindërve, arsimtarëve, përfaqësuesve të komunave dhe institucioneve shtetërore arsimore, si dhe palët tjera të interesuara

TË ARRITURAT KRYESORE TË PROJEKTIT JANË:

- ➔ 175 arsimtarë që ligjërojnë edukatë qytetare dhe shoqëri janë trajnuar të përdorin metodologji mësimore dhe qasje relevante për integrim ndëretnik në mësim
- ➔ 5000 nxënës të përkatësisë së ndryshme etnike morën pjesë aktive në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve
- ➔ 2000 nxënës morën pjesë drejtpërdrejt në aktivitete të ndryshme në kuadër të seksioneve
- ➔ Më shumë se 2000 nxënës morën pjesë në orë të përbashkëta me nxënës që ndiqnin mësim në gjuhë të ndryshme mësimore
- ➔ Më shumë se 500 prindër janë të përfshirë në aktivitete të ndryshme në shkollë bashkë me fëmijët e tyre
- ➔ 340 nxënës dhe 50 arsimtarë morën pjesë në programin dyjavor për shkëmbim ndërkulturor në Trogen, Zvicër.
- ➔ 950 arsimtarë dhe drejtorja e shkollës prej 18 shkollave u trajnuan për risitë e Treguesve për cilësinë e punës së shkollës (TCPSH) lidhur me INA
- ➔ Instrumentet për vëzhgimin e mësimit nga aspekti i INA-s të zhvilluara në bashkëpunim me BZHA-në përdoren në nivel kombëtar

2. KORNIZË KONCEPTUESE PËR HULUMTIMIN

Në realizimin e lëndës edukatë qytetare ndikojnë situatat vijuese:

1. Numri i vogël i orëve me të cilat mësohet lënda (nga një orë në javë në klasën e tetë dhe të nëntë) e imponoi çështjen e punësimit të kuadrit mësimor sipas normativit, veçanërisht në shkollat e vogla dhe rezultoi me atë që lëndën edukatë qytetare ta ligjërojnë arsimtarë më arsim joadekuat⁴. Krahas kësaj edhe sociologët, të cilët sipas normativit për kuadër mësimor janë adekuat për të realizuar mësimin, gjatë studimeve nuk janë përgatitur në mënyrë specifike për të ligjëruar edukatë qytetare. Nuk ka hulumtime për atë se si realizohet mësimi nga edukata qytetare dhe sa janë përkatëse dhe efektive metodat që i përdorin arsimtarët për arritjen e qëllimeve siç janë të kuptuarit e të drejtave dhe përgjegjësi dhe praktikimi i tyre në shkollë, bashkësinë lokale dhe në shoqëri më gjerë, e kjo është bazë për zhvillimin e vlerave demokratike.
2. Vendosja e testimit ekstern dhe llojet e detyrave që përdoren në të mund të ndikojë në atë që fokusi të zhvendoset drejt qëllimeve që kanë të bëjnë me dituri, ndërsa të anashkalohen qëllimet e niveleve më të larta kognitive dhe nga fusha afektive e zhvillimit të nxënësve.
3. Detyrimisht realizimi i përmbajtjeve nga Shkathtësitë jetësore dhe disa nga lëndët zgjedhore mund të ndikojë në realizimin e disa pjesëve të programeve nga edukata qytetare dhe ka nevojë për rishqyrtimin e tyre.
4. Kishte reagime në media lidhur me lëshimet në librat shkollor, që shkaktuan polemikë lidhur me cilësinë e tyre. Krahas reagimeve në opinion dhe të arsimtarëve se në librin shkollor ka të dhëna

të vjetërsuara⁵ nuk është ngritur iniciativë për rivlerësim dhe rishikim të librave shkollor.

5. Arsimtarët nuk kanë doracakë për realizimin e mësimin, që bashkë me faktin se një numër i madh i tyre nuk janë me kualifikim përkatës për të ligjëruar edukatë qytetare mes tjerash ndikon në cilësinë e mësimin.
6. Maqedonia angazhohet fuqimisht për ta bërë arsimin më të përputhje me vendet e zhvilluara dhe të krahasuar ndërkombëtarisht, por deri tani nuk është përfshirë në aktivitete që mundësojnë krahasime të Maqedonisë me shtete tjera. Ekzistojnë më shumë studime ndërkombëtare për vlerësimin e të arriturave të nxënësve nga edukata qytetare, prej të cilave më e njohur është Civic Education (CIVED) e International Association for Evaluation of the Educational Achievements (IEA)⁶ me të cilin janë përfshirë më shumë se 30 vende, ndërsa studimi, gjegjësisht kontrolli i diturive dhe të arriturat e nxënësve (të moshës 14 vjeçe) kontrollohen çdo shtatë vite

Nëse Republika e Maqedonisë synon të ndërtojë shoqëri demokratike dhe civile dhe është e orientuar drejt integriteteve në Bashkimin Evropian, është mirë që nga moshën më të hershme t'i arsimojë nxënësit në këtë frymë dhe t'i shkëmbejë vlerat e njëjta. Në këtë mënyrë, programet mësimore do të duhej t'i ndjekin temat/fushat themelore që i mbulon edukata qytetare në vendet pjesëmarrëse në studimin CIVED, e këto janë:

- ➔ Demokraci dhe shoqëri civile (Demokracia dhe karakteristikat e saj, Institucione dhe praktikim i demokracisë, Qytetarë – të drejta dhe obligime)
- ➔ Identitet kombëtar, marrëdhënie rajonale dhe ndërkombëtare
- ➔ Kohezion social dhe diversitete (si i shikojnë nxënësit kohezionin social dhe diversitetet, si e përjetojnë diskriminimin, rëndësinë e mediave, ekonominë dhe problemet lokale duke përfshirë mjedisin jetësor).

⁴ Më shumë se gjysma (53%) e arsimtarëve që ligjërojnë edukatë qytetare nuk janë adekuatë sipas normativit për kuadër mësimor, ndërsa vetëm 13% kanë mbaruar studime të sociologjisë (shiko tabelën 2 në pjesën 4.2 të këtij raporti)

⁵ P.sh. në librin shkollor qëndron se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ka 120 deputetë, e në fakt janë 123, informacionet për numrin e anëtarëve të BE-së janë të vjetra (të pasakta)

⁶ <http://www.iea.nl/iccs-past-cycles>



Përmbajtjet në programin mësimor nga Edukata qytetare për klasën e tetë dhe të nëntë vetëm pjesërisht përputhen me përmbajtjet e përmendura më sipër.

Duke marrë parasysh atë që u tha më parë është zbatuar hulumtim i karakterit eksplorues (të konstatohet gjendja) në çka theksi është vendosur në fushat vijuese:

A) PROGRAMET MËSIMORE NGA EDUKATA QYTETARE para së gjithash në raport me:

- ➔ nevojën e lëndës mësimore dhe cilësinë e programit mësimor
- ➔ rëndësinë e përmbajtjeve mësimore
- ➔ nevojën për përmirësimin e programit mësimor

B) REALIZIM I MËSIMIT DHE NXËNIES

me ç'rast janë hulumtuar:

- ➔ metoda të realizimit të mësimit
- ➔ metoda të mbështetjes së nxënies.

C) PERCEPTIME TË LIBRAVE SHKOLLOR

me ç'rast janë hulumtuar:

- ➔ mendime të arsimtarëve dhe të nxënësve për librat shkollor
- ➔ nevoja për materiale plotësuese

Ç) PERCEPTIME PËR TRAJNIMET nga aspekti i

- ➔ trajnimeve të ndjekura dhe nevojës për trajnime dhe mbështetje profesionale

D) MENDIME PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE TË MËSIMIT

- ➔ mendime të arsimtarëve për arritjen e qëllimeve
- ➔ mendime dhe angazhim shoqëror i nxënësve



3. METODA DHE INSTRUMENTE PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Në përputhje me kornizën konceptuese, në këtë hulumtim janë mbledhur të dhëna nga arsimtarët e lëndës Edukatë qytetare dhe nga nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë që e kanë mësuar lëndën në vitin shkollor 2015/16. Për nevojat e këtij hulumtimi janë përpiluar: pyetësorë dhe protokolle për udhëheqjen e fokus grupeve.

Të dhënat e mbledhura janë sasiore dhe cilësore.

HULUMTIM I ARSIMITARËVE

Nga arsimtarët janë mbledhur: mendime për programet mësimore dhe për librat shkollorë, të dhëna për metoda të realizimit të mësimit, për mënyrat e mbështetjes së nxënies së nxënësve, trajnime dhe nevojë për trajnime dhe vlerësime për arritjen e qëllimeve të programeve mësimore. Të dhënat e arsimtarëve janë mbledhur me *Pyetësor për arsimtar* në formë elektronike për përgjigjen e të cilit nevojiteshin rreth 20 minuta dhe përmes diskutimeve në fokus grupe.

HULUMTIM I NXËNËSVE

Nga nxënësit janë mbledhur informacione dhe mendime për çështje të ngjashme si edhe ato nga arsimtarë me qëllim që të sigurohet besueshmëri më e madhe e të dhënave. Ato janë mbledhur me *Pyetësor për nxënësit* në formë elektronike për përgjigjen e të cilit nevojiteshin rreth 30 minuta dhe përmes diskutimeve në fokus grupet me nxënësit.

Në tabelën më poshtë është dhënë përshkrim i çdo instrumenti që është i dobishëm në hulumtimin.

TABELA 1. PËRSHKRIM I INSTRUMENTEVE TË PËRDORURA NË HULUMTIMIN

INSTRUMENT	PËRSHKRIM I SHKURTËR
PYETËSOR PËR ARSIMITARËT E EDUKATËS QYTETARE	Pyetësori për arsimtarë përbëhej prej: <ul style="list-style-type: none"> ➤ 25 pyetjeve të hapura, të mbyllura ose kombinuara (pyetje e mbyllur me kërkim të arsytimit të përgjigjes). Katër prej pyetjeve ishin klasterë. ➤ Përgjigjja në pyetjet ishte përmes rrugës elektronike dhe anonime.
PROTOKOLL PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMIT NË FOKUS GRUP ME ARSIMITARË	Protokolli përmbante udhëzime të udhëheqjes së fokus grupeve dhe 17 pyetje orientuese për diskutim, në tema të ngjashme si në pyetësorin për arsimtarë.
PYETËSOR PËR NXËNËSIT	Pyetësori për nxënësit të klasës së tetë dhe të nëntë përbëhej prej: <ul style="list-style-type: none"> ➤ 25 pyetjeve të llojit të hapur, të mbyllur ose kombinuar (pyetje e mbyllur me kërkim të arsytimit të përgjigjes). Tre prej pyetjeve ishin klasterë. ➤ Përgjigjja e pyetësorit ishte organizuar në shkollë, në klasë me kompjuterë përmes rrugës elektronike dhe anonime.
PROTOKOLL PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMIT NË FOKUS GRUP ME NXËNËS	Protokolli përmbante udhëzime të udhëheqjes së fokus grupeve dhe 12 pyetje orientuese për diskutim, në tema të ngjashme si në pyetësorin.

4. EKZEMPLAR

4.1. NXËNËS

Ekzemplari i nxënësve është zgjedhur në dy hapa. Së pari, të gjitha shkollat fillore janë grupuar në tre rajone: Lindor, Perëndimor dhe Shkup. Më pas në kuadër të secilit rajon janë zgjedhur 44 shkolla⁷ me ç'rast i kushtohet rëndësi shpërndarjes territoriale dhe gjuhës mesimore (të ketë nxënës nga mësimi në gjuhën mesimore maqedonase dhe atë shqipe). Në kuadër të shkollës, sipas zgjedhjes së rastësishme janë zgjedhur nga 10 nxënës (nga 5 nxënës të klasës së tetë dhe të nëntë).

Pyetësorit i janë përgjigjur gjithsej 542⁸ nxënës. Struktura e ekzemplarit nxënës sipas gjuhës mesimore⁹, një klasë e gjysmë është paraqitur në tabelën vijuese.

TABELA 1. EKZEMPLAR I NXËNËSVE

	NUMRI	%	NUMRI	%
GJINIA	FEMRA		MESHKUJ	
	316	58,3	226	41,7
GJUHA MËSIMORE	MAQEDONASE		SHQIPE	
	366	67,5	176	32,5
KLASA	TETË		NËNTË	
	186	34,3	356	65,7
GJITHSEJ NXËNËS: 542				

Ekzemplari nuk është reprezentativ për të gjithë nxënësit e klasës së tetë dhe nëntë në Republikën e Maqedonisë, por duke marrë parasysh madhësinë e tij (mbi 1% e popullatës – numri i përgjithshëm i nxënësve në klasën e 8-të dhe 9-të), llojllojshmërinë dhe nivelin e përpunimit të të dhënave ky mund të konsiderohet si relevant për përcaktimin e mendimeve të nxënësve.

7 Lista e shkollave është dhënë në Shtojcën 1.

8 Në disa shkolla janë paraqitur vullnetarisht për të marrë pjesë në hulumtimin edhe nga disa nxënës ndaj numri i zgjedhur fillimisht prej 440 nxënësve është rritur.

9 Hulumtimi është zbatuar me nxënës të gjuhës mesimore maqedonase dhe shqipe për shkak se në këto dy gjuhë mësojnë 96,8% e të gjithë nxënësve në shkollat fillore (Enti Shtetëror për Statistikë – Shkolla fillore dhe të mesme në fund të vitit shkollor 2014/2015 - <http://www.stat.gov.mk/pdf/2016/2.1.16.06.pdf>). Gjuha mesimore nuk përputhet gjithmonë me përkatësinë etnike. Në të dyja gjuhët mësojnë edhe nxënës të përkatësive tjera etnike: romë, boshnjakë, etj..

Në diskutimin në 5 fokus grupe me nxënës (Tetovë 2 fokus grupe, Shkup 2 fokus grupe, Strumicë 1 fokus grup) kanë marrë pjesë gjithsej 56 nxënës.

4.2. ARSIMTARË

Pyetësorët për arsimtarë janë vendosur në platformën e SurveyMonkey dhe arsimtarët e edukatës qytetare nga të gjitha shkollat fillore janë lutur që të përgjigjen. Janë përgjigjur 241 arsimtarë (200 nga mësimi në gjuhën maqedonase dhe 41 nga mësimi në gjuhën mesimore shqipe) prej 177 shkollave¹⁰. Kjo është rreth 51% e numrit të përgjithshëm (345) të shkollave, gjegjësisht 53% nga numri i përgjithshëm i arsimtarëve (454). Duke marrë parasysh se ekzemplari i arsimtarëve të anketuar është mbi gjysmën e popullatës, ndërsa për nga struktura arsimore përputhet me të (shiko tabelën 2) përgjigjet e tyre mund të konsiderohen si relevante për të gjithë arsimtarët e edukatës qytetare në Republikën e Maqedonisë.

Më poshtë janë dhënë të dhëna për strukturën arsimore dhe stazhin e punës të arsimtarëve në ekzemplarin.

TABELA 2. STRUKTURA ARSIMORE E ARSIMTARËVE NGA EDUKATA QYTETARE

PROFILI ARSIMOR	POPULLATA		EKZEMPLAR	
	NUMRI	%	NUMRI	%
SOCIOLOGJI	61	13,4	50	20,7
PROFESOR I HISTORISË	152	33,5	54	22,4
ARSIM TJETËR SIPËROR	197	39,4	96	38,8
AKADEMI PEDAGOGJIKE	44	13,7	41	17,0
GJITHSEJ	454	100	241	100

Struktura arsimore e arsimtarëve të edukatës qytetare në ekzemplar përputhet me atë në popullatën, veçanërisht nëse kategorinë e sociologëve dhe profesorëve të historisë i shikojmë si një kategori: adekuat sipas normativit për kuadër mesimor.

10 Lista e shkollave është dhënë në Shtojcën 2



**TABELA 3. STAZHI I PUNËS I
ARSIMTARËVE NË EKZEMPLARIN**

STAZHI I PUNËS	NUMRI	%
deri 1 vit	31	12,9
2 – 5 vite	61	25,3
6 – 10 vite	76	31,5
11-15 vite	63	26,1
Mbi 15 vite	10	4,1
GJITHSEJ	241	100

Sipas të dhënave për stazhin e punës e arsimtarëve në ekzemplarin konstatohet se më shumë se një e treta kanë më pak se 5 vite stazh. Duke marrë parasysh se ata paraqesin më shumë se gjysmën e popullatës me siguri gjendja është e ngjashme me numrin e përgjithshëm të arsimtarëve të edukatës qytetare.

Në diskutimet në 4 fokus grupe (Tetovë 1, Shkup 2, Strumicë 1) kanë marrë pjesë gjithsej 42 arsimtarë.




5. MBLEDHJE, PËRPUNIM DHE ANALIZË E TË DHËNAVE

Mbledhja e të dhënave u realizua nga këshilltarët e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe një përfaqësues i vetëqeverisjes lokale, i cili ka përvojë nga ky lloj i hulumtimeve. Ata e organizuan dhe në të shumtën e rasteve e zbatonin anketimin e nxënësve dhe i udhëhiqnin diskutimet në fokus grupet. Për ta së pari u organizua trajnimi njëditor.

Mbledhja e të dhënave u realizua në maj dhe qershor të vitit 2016.

Të dhënat nga pyetësorët elektronik u transmetuan në programin SPSS i cili përdorej për përpunimin e përgjigjeve. Duke marrë parasysh karakterin e hulumtimit janë përdorur procedura nga statistika deskriptive.

Për diskutimet në fokus grupet janë mbajtur shënime të hollësishme, që më pas janë përpunuar me analizë tematike të përmbajtjes.



REZULTATE

Në pjesën e dytë janë paraqitur të dhënat e fituara nga hulumtimi sipas fushave të hulumtimit të përkufizuara në kornizën konceptuese. Të dhënat janë tregues për gjendjen aktuale me realizimin e mësimit nga lënda Edukatë qytetare dhe duke marrë parasysh madhësinë dhe përfaqësimin e ekzemplarit, veçanërisht të ekzemplarit të arsimtarëve, mund të konsiderohet si relevante për gjithë shtetin¹¹.



1. PERCEPTIM PËR PROGRAMET MËSIMORE

1.1. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE MËSIMORE

Me reformat e fundit në arsimin fillor, miratimi i Konceptcionit për arsim fillor nëntëvjeçar dhe edukim¹² dhe Planit mësimor për arsim fillor¹³, lënda mësimore Edukatë qytetare mësohet si lëndë e detyrueshme në klasën e tetë dhe të nëntë me fond javor prej 1 ore, gjegjësisht 36 orë fond vjetor të orëve.

Mësimi i lëndës mësimore edukatë qytetare rezulton nga parimet e arsimit fillor në Republikën e Maqedonisë¹⁴ të vendosur në Konceptcionin, para së gjithash, parimin e demokracisë dhe parimin e mosdiskriminimit, sipas të cilave arsimit i fëmijëve duhet të jetë i orientuar drejt zhvillimit të personalitetit dhe vlerave themelore të njeriut, lirisë individuale, integritetit, dinjitetit dhe të drejtave të barabarta, mbi të cilat edhe shkolla krijon kushte për forcimin e ndjenjës së drejtësisë, tolerancës dhe përgjegjësisë, si dhe përgatitje për jetë të përgjegjshme në një shoqëri demokratike civile.

Duke marrë parasysh faktin se lënda mësimore edukatë qytetare mësohet në periudhën e fundit të arsimit fillor (klasa VII-IX), në programet mësimore janë dhënë qëllime zhvillimore për periudhën, në bazë të cilave konkretizohen qëllimet dhe përmbajtjet në çdo klasë.

Kështu, numri më i madh i qëllimeve kanë të bëjnë me njoftimin e idesë për të drejtat e njeriut, Deklaratën universale për të drejtat e njeriut, Konventën evropiane për të drejtat e njeriut, lidhshmërinë mes të drejtave, lirive dhe përgjegjësisive të njeriut dhe gjendjes dhe realizimit të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë, si dhe rëndësinë e anëtarësimi të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

¹¹ Gjatë shqyrtimit të të dhënave që kanë të bëjnë me qëndrimet dhe mendimet e arsimtarëve, duhet marrë parasysh tendencën e të anketuarve që të paraqiten pozitivisht që është vërejtur në të gjitha hulumtimet e deritanishme që kanë të bëjnë me praktikën mësimore.

¹² Konceptioni për arsim fillor nëntëvjeçar dhe edukim, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, 2007

¹³ Plan mësimor për arsim fillor nëntëvjeçar <http://bro.gov.mk/docs/nastavniplanovi/nastaven%20plan%20devetgodishno%202015-2016.pdf>

¹⁴ Konceptioni për arsim fillor nëntëvjeçar dhe edukim, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, 2007 faq. 65-67

Temat përmes të cilave realizohen qëllimet në programin mësimor për klasën e tetë janë si vijon:

NJERIU, TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E NJERIUT

➔ Në këtë temë janë dhënë përmbajtjet vijuese:

Si janë krijuar të drejtat e njeriut, Të drejta civile dhe politike, Të drejta sociale-ekonomike, Të drejta ekologjike zhvillimore dhe kulturore, Të drejta të fëmijëve, Të drejta të grave, Përgjegjësi, Shkelje dhe mbrojtje e të drejtave të njeriut.

DEMOKRACI DHE SHOQËRI CIVILE

➔ Në këtë temë si përmbajtje janë dhënë:
Demokracia, Roli i qytetarëve në demokraci

BASHKIMI EVROPIAN

➔ Në këtë temë janë zhvendosur përmbajtjet vijuese:
Bashkimi Evropian dhe krijimi i tij, Puna e Bashkimit Evropian, Integrimi i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Programin mësimor për klasën e nëntë e përbëjnë temat vijuese:

PUSHTET

➔ Si përmbajtje në këtë temë janë:
Udhëheqja e shoqërisë, Pushteti në Republikën e Maqedonisë

KONFLIKT

➔ Përmbajtje:
Kultura dhe paqja, Krijimi dhe përballja me konfliktin

HULUMTIMI I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE

➔ Përmbajtje:
Dëshmitar dhe dinjitet, Akt humanitar dhe presion social, Dilemë dhe dëshmitar, Bazat e së drejtës ndërkombëtare humanitare, e drejta ndërkombëtare humanitare dhe të drejtat e njeriut, Shkelje e së drejtës ndërkombëtare humanitare, Krim lufte, Sanksionim i shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare humanitare, Veprim humanitar.

MEDIA

➔ Përmbajtje:

Informimi në shoqërinë bashkëkohore

Për secilën temë janë parashikuar numër i caktuar i orëve.

Sipas matricës për përpilimin e programeve mësimore, paralelisht me qëllimet dhe përmbajtjet konkrete, janë dhënë edhe kuptimet themelore që duhet t'i përvetësojë nxënësi, si dhe shembuj të aktiviteteve për arsimtarin se si të realizojë një qëllim të caktuar (aktivitete dhe metoda).

Në programin mësimor në pjesën e Rekomandimeve didaktike janë dhënë drejtime të përgjithshme për realizimin e programit me metoda dhe aktivitete për nxitjen e nxënësve.

Programet mësimore janë miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (nr. 07-9561 nga 08.12. të vitit 2008 për klasën e tetë dhe nr. 10-3258/2 nga 20.10. të vitit 2009 për klasën e nëntë).

Mësimin e edukatës qytetare, në përputhje me Normativin e kuadrit mësimor, e realizon arsimtari me studime të mbaruara nga sociologjia, e nëse nuk paraqitet kandidat adekuat, mësimin mund ta realizojë edhe një arsimtar me studime të mbaruara nga historia.

Të gjitha qëllimet dhe përmbajtjet në programet kanë të bëjnë me përvetësimin e njohurive nga fusha e edukatës qytetare, mirëpo mund të konstatohet se gjatë krijimit të programit nuk janë respektuar mjaftueshëm parimet e arsimit fillor në Republikën e Maqedonisë dhe angazhimet për krahasim ndërkombëtar të rezultateve nga nxënia e nxënësve, si dhe praktika përkatëse ndërkombëtare në mësimin e edukatës qytetare.

Po ashtu, gjatë zhvillimit të programit mësimor përveç arritjes së diturive nga fusha e edukatës qytetare, do të duhej të punohet në zhvillimin e shkathtësive për interpretim, ndërtim të qëndrimeve, koncepteve dhe nxitje të veprimit në shoqërinë civile.

Në bazë të përvojave të deritanishme në sistemin tonë arsimor nga mësimi i edukatës qytetare dhe duke marrë parasysh përvojat ndërkombëtare duhet të rishqyrtohet koncepti i mësimin të lëndës mësimore edukatë qytetare dhe lidhshmëria me lëndë tjera mësimore dhe aktivitete jashtëmësimore.

1.2. MENDIME PËR PROGRAMET MËSIMORE

Mësimi, sipas programeve ekzistuese mësimore për edukatë qytetare, realizohet tashmë tetë vite, që është një periudhë mjaft e gjatë që të mund të përmblihen mendimet relevante të arsimtarëve dhe nxënësve lidhur me qëllimet dhe përmbajtjet që mësohen. Në këtë hulumtim mendimet për programet mësimore janë mbledhur prej (1) arsimtarëve që e ligjërojnë lëndën dhe prej (2) nxënësve të klasës së 8-të dhe 9-të që e mësojnë lëndën edukatë qytetare. Në këtë pjesë të raportit janë paraqitur mendimet e tyre që janë marrë përmes përgjigjes në pyetjet në pyetësor dhe të shprehura gjatë diskutimeve në fokus grupe. Mendimet janë grupuar në dy fusha tematike: 1. Mendime të përgjithshme për lëndën mësimore dhe programin mësimor dhe 2. Mendime për përmbajtjet mësimore.

MËNYRË E HULUMTIMIT

Mendimet për lëndën mësimore të arsimtarët janë hulumtuar me 5 pyetje nga Pyetësori për arsimtarë dhe 5 pyetje për diskutim në fokus grupet, ndërsa të nxënësit me 5 pyetje nga Pyetësori për nxënës dhe 4 pyetje për diskutim në fokus grupet.

Pyetjet në pyetësorët ishin të llojit të mbyllur dhe hapur. Dy pyetje nga pyetësori për arsimtarë dhe një nga pyetësori për nxënës ishin klastere.

1.2.1. MENDIME TË PËRGJITHSHME PËR LËNDËN MËSIMORE DHE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

MENDIM PËR NEVOJËN E MËSIMIT TË LËNDËS EDUKATË QYTETARE

Mendime për nevojën e mësimin të edukatës qytetare janë kërkuar vetëm nga nxënësit. Supozohej se të gjithë arsimtarët që e ligjërojnë këtë lëndë do të jenë për ekzistimin e saj. Prandaj, arsimtarët u pyetën vetëm për përshtatshmërinë e numrit të orëve për mësimin e lëndës.

Në pyetjen: *Çfarë pritnit të mësoni nga lënda mësimore: Edukatë qytetare?* Nxënësit në fokus grupet kanë treguar se pritjet e tyre kanë qenë jo mjaft të qarta ("për qytetarët, për vendlindjen, sipas emrit të lëndës; për gjykatat dhe policinë; për politikën; për njerëzit, për qytetarët") dhe kryesisht negative ("Gjithmonë kur përballemi me lëndë të re, përshtypja jonë e parë është: ja,

do të duhet të mësojmë edhe një lëndë pa lidhje, kështu ishte edhe me këtë lëndë; menduam se do të jetë vështirë").

Nxënësit në pyetësorin duhej të përmendin tri gjëra që kanë pritur se do t'i mësojnë nga edukata qytetare, para se të fillojnë ta mësojnë këtë lëndë. Përgjigje më të shpeshta në këtë pyetje në pyetësorin janë:

- ➔ Për të drejtat e njeriut (276);
- ➔ Për Bashkimin Evropian (174 nxënës);
- ➔ Për demokracinë (139);
- ➔ Për shoqërinë/shtetin (108 nxënës);
- ➔ Për politikë (70).

Pritjet e nxënësve nga aspekti i përmbajtjes së lëndës në masë të madhe përputhen me përmbajtje që mësohen. Thuajse të gjithë nxënësit (97%) janë përgjigjur se në këtë lëndë janë përfshirë të gjitha përmbajtjet që kanë pritur se do t'i mësojnë.

Nxënësve, në pyetësorin, u është parashtruar pyetja: *Ka mendime të ndryshme nëse duhet të mësohet lënda Edukatë qytetare. Shkruaj disa arsye pse duhet të mësohet, e pse nuk duhet të mësohet.*

Numri më i madh i nxënësve që janë përgjigjur në këtë pyetje konsiderojnë se duhet të mësohet edukatë qytetare. Arsyetimet më të shpeshta për nevojën e edukatës qytetare kanë qenë për shkak se mësojnë gjëra të dobishme që mund të zbatohen në jetën e përditshme (150 nxënës) dhe për shkak se mësohet për të drejtat e njerëzve (91 nxënës). Më poshtë, për ilustrim janë dhënë disa nga përgjigjet më përmbajtësore të nxënësve.

„Edukata qytetare të ndihmon t'i kuptosh problemet me të cilat përballlet bashkësia në të cilën mëson dhe jeton“.

„Përvetësojmë njohuri për jetën që vijon, e dimë se si funksionojnë organet shtetërore që do të jenë kyçe për ne pasi të përfundojmë arsimin, përvetësojmë aftësi dhe vlera themelore morale, përgatitemi të hyjmë në botën e të moshuarve“.

„Na i tregojnë të drejtat e njeriut dhe na ndihmon në marrjen e vendimeve të drejta“.

„Nëse dikush ka për qëllim të jetë avokat ose ngjashëm do t'i duhen të drejtat. Po ashtu, lënda ndihmon nxënësit të kenë mendim ndryshe për disa probleme dhe zgjidhjet e tyre“.

Një numër i vogël i nxënësve janë përgjigjur se nuk duhet të mësohet edukata qytetare. Arsyetimet më të shpeshta për këtë janë se: ka shumë përmbajtje që kanë të bëjnë me politikën (13 nxënës) dhe një pjesë të madhe të përmbajtjeve i kanë ditur nga jeta e përditshme dhe nga lëndët tjera mësimore (18 nxënës).

Edhe në fokus grupet nxënësit ndonjëherë flitnin për nevojën e mësimit të edukatës qytetare. Në favor të nevojës së tillë në të shumtën e rasteve flitnin nxënësit që janë të kënaqur nga mësimi i lëndës mësimore. *“Edukatë qytetare është dashur të fillojmë të mësojmë më herët, që në klasën e parë. Prej atëherë duhej të mësojmë se si të shoqërohemi, si të bëhemi humanë, prandaj konsideroj se klasa e tetë është vonë për të filluar me mësimin e edukatës qytetare”* (deklaratë e nxënësit).

Njëra prej pyetjeve për të cilat u bisedua në fokus grupet me nxënës ishte: A ju pëlqen lënda? Çfarë ju pëlqen, e çfarë jo. Numri më i madh i nxënësve u prononcuan se **u pëlqen lënda edukatë qytetare.**

Arsyetimet kanë të bëjnë me:

nevojën: *“Na është shumë e dobishme në jetë, na mëson se si të jetojmë drejt, të jemi të sjellshëm, të dimë për zakonet e feve tjera”*,

Përmbajtjet: *“Mësojmë për të drejtat e njeriut; flitet për kulturën, për qytetarët; mësuam se çfarë është BE-ja”*

Mënyrat e punës në orë: *“Mësojmë prej shembujve dhe menjëherë kuptojmë; në orë ndjehemi sikur kemi orë të lirë, tërë kohën punohet në mënyrë ndërvepruese; veçanërisht e kemi mirë kur shënojmë ditë të posaçme për të cilat nuk kemi ditur deri tani; arsimtarja është shumë e mirë dhe na sqaron me shembuj”.*

Te një numër i vogël i nxënësve të cilëve lënda nuk u pëlqen arsyetimi ka të bëjë me atë se *“tërë kohën përsëritet e njëjta gjë”*

Lidhur me **numrin e orëve** në të cilat mësohet lënda edukatë qytetare 74% e arsimtarëve që janë përgjigjur në pyetjen konsiderojnë se një orë në javë nuk mjafton. Në fokus grupet edhe nxënësit edhe arsimtarët, ndonjëherë kanë shprehur mendimin se për shkak të fondit të vogël të orëve nuk ka kohë të mjaftueshme për përfshirje aktive të nxënësve dhe për sqarim plotësues të përmbajtjeve.

MENDIME PËR PROGRAMIN MËSIMOR NGA EDUKATA QYTETARE

Në pyetësorin për arsimtarë kërkohej që arsimtarët t'i përshkruajnë përparësitë dhe dobësitë e programit mësimor dhe të japin propozime konkrete për përmirësimin e tij. Këto pyetje ishin objekt e diskutimit edhe në fokus grupet me arsimtarë. Shumica e përgjigjeve, në fakt, nuk kanë të bëjnë konkretisht me programin mësimor, por me pyetje të ndryshme që kanë të bëjnë me mësimin nga kjo lëndë. Më poshtë janë dhënë vetëm përgjigjet që kanë të bëjnë me programin.

PËRPARËSI:

Përmbajtjet janë adekuate për shkak se: u ndihmojnë nxënësve për jetën e përditshme/arsimin e mëtejshëm (50 arsimtarë) dhe nxënësit i mësojnë të drejtat (31 arsimtarë).

Metodat e rekomanduara i nxisin nxënësit për pjesëmarrje aktive, hulumtim, mendim kritik (19 arsimtarë).

DOBËSI:

Fondi i vogël i orëve (30 arsimtarë). *“Duhet të ketë më shumë orë për ushtrime dhe përsëritje”*

Disa arsimtarë në diskutimet në fokus grupet janë ankuar në vështirësitë e realizimit të temës: Pushtet, *“për shkak se nuk mund të krahasohet me realitetin në shtetin tonë. Për të njëjtën gjë na reagojnë edhe nxënësit”.*

PROPOZIME PËR PËRMIRËSIM

Numri më i madh i propozimeve për përmirësim kishin të bëjnë me plotësimin e përmbajtjeve dhe ato janë dhënë në pjesën 1.2.2. Propozimet tjera për përmirësim, në fakt, kishin të bëjnë me krijimin e kushteve për realizimin e programit, si p.sh. sigurimi i doracakut, CD, materialeve/përmbajtjeve digjitale, mbështetje nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit (40 arsimtarë); sigurim të librit më të mirë shkollor (28 arsimtarë); trajnime plotësuese për arsimtarë, në të cilat arsimtarët do të konsultohen për atë që duhet të hidhet poshtë/të plotësohet në mësimin nga Edukata qytetare (15 arsimtarë).

PËRSHTATJE E EMRIT TË LËNDËS MËSIMORE

Që nga vendosja e mësimit të përmbajtjeve që kanë të bëjnë me shoqërinë civile, demokracinë, të drejtat e njeriut... paraqiteshin mendime të ndryshme lidhur me atë nëse këto përmbajtje duhet të mësohen (dhe) në kuadër të lëndës së posaçme mësimore, çfarë duhet të përmbajë ajo, si të quhet. Sipas përgjigjeve të nxënësve dhe arsimtarëve duket se ata e kanë pranuar emrin e lëndës. Me fjalë tjera, 90% e arsimtarëve dhe e nxënësve konsiderojnë se emri i lëndës mësimore është i përshtatshëm me përmbajtjet që mësohen.

1.2.2. MENDIME PËR RËNDËSINË E PËRMBAJTJEVE MËSIMORE NGA EDUKATA QYTETARE


Kur bëhet fjalë për programet mësimore objekti më i shpeshtë i interesit janë përmbajtjet mësimore. Për secilën prej temave në programet mësimore, nxënësit dhe arsimtarët janë pyetur nëse është e rëndësishme dhe interesante.

RËNDËSIA E TEMAVE MËSIMORE QË MËSOHEN

Lidhur me atë se sa konsiderojnë se është e rëndësishme secila nga temat që mësohet, arsimtarët vlerësonin se sa ata personalisht konsiderojnë se secila nga temat është e rëndësishme, ndërsa sa konsiderojnë se secila prej temave u është e rëndësishme nxënësve. Nxënësit, po ashtu, janë pyetur se sa u është e rëndësishme secila prej temave. Përgjigjet janë paraqitur në Grafikonin nr.1

Sipas përgjigjeve të numrit më të madh, mbi 60%, e nxënësve dhe madje mbi 80% e arsimtarëve u janë të rëndësishme të gjitha temat nga programi mësimor. Temat që mësohen në klasën e tetë vlerësohen si më të rëndësishme nga ato që mësohen në klasën e nëntë. Si më të rëndësishme edhe nga arsimtarët edhe nga nxënësit janë vlerësuar temat: Njeri, të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut dhe Demokracia dhe shoqëria civile.

Për secilën prej temave është më i madh numri i arsimtarëve të cilët konsiderojnë se tema në përgjithësi është e rëndësishme, sesa i atyre që konsiderojnë se u është e rëndësishme nxënësve. Nxënësve, nga ana tjetër, sipas përgjigjeve të tyre, secila prej temave u është më pak e rëndësishme sesa që arsimtarët konsiderojnë se u është e rëndësishme. Më së shumti janë të përputhura mendimet për rëndësinë e temave: Njeriu, të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut dhe Demokraci dhe shoqëri civile. Dallimet në vlerësimet për rëndësinë e temave të caktuara ndërmjet arsimtarëve dhe nxënësve janë më të mëdha për temën: Media, për të cilën rreth 90% arsimtarë konsiderojnë se është e rëndësishme, dhe se u është e rëndësishme edhe nxënësve, derisa 60% e nxënësve janë përgjigjur se për ta kjo temë është e rëndësishme. Kjo mund të jetë tregues që të rishikohen përmbajtjet që mësohen në këtë temë. Edhe arsimtarët edhe nxënësit e konsiderojnë temën: Hulumtim i së drejtës ndërkombëtare humanitare, si më pak të rëndësishme nga temat tjera.



Grafikoni 1. Mendime për rëndësinë e temave në programin për Edukatë qytetare




SA JANË INTERESANTE TEMAT MËSIMORE QË MËSOHEN

Një program do të realizohet më me sukses nëse përmbajtjet që ligjërohen dhe mësohen janë interesante për nxënësit, por edhe për arsimtarët. Lidhur me përmbajtjet në edukatën qytetare në opinionin më të gjerë ekzistojnë mendime të ndryshme. Prandaj në anketimin e arsimtarëve u është parashtruar pyetja

për secilën nga temat, nëse është interesante për ta dhe nëse është interesante për nxënësit. Nxënësve, po ashtu, u është parashtruar pyetja për secilën temë nëse u është interesante. Për atë se sa janë interesante për nxënësit përmbajtjet në edukatën qytetare u bisedua edhe në fokus grupet me arsimtarë dhe me nxënës.

Në Grafikonin nr. 2 janë paraqitur të dhënat përmblendhëse nga përgjigjet e arsimtarëve dhe nxënësve.



Grafikoni 2. Mendime për atë se sa janë interesante temat në programin për Edukatë qytetare

Të gjitha temat që mësohen në edukatën qytetare u janë interesante më shumë se 70% të arsimtarëve dhe 60% të nxënësve. Si edhe në vlerësimin për rëndësinë, edhe këtu ekzistojnë dallime të rëndësishme në mendimet e nxënësve dhe mendimet e arsimtarëve për atë se sa u janë interesante nxënësve disa tema të caktuara. Me fjalë tjera, është më e vogël përqindja e nxënësve që janë përgjigjur se një temë e caktuar u është interesante për dallim nga përqindja e arsimtarëve që kanë konsideruar se kjo temë është interesante për nxënësit. Më të mëdha janë dallimet në mendimet e nxënësve dhe arsimtarëve për temat: Media dhe Pushtet.

Më interesante edhe sipas nxënësve edhe sipas arsimtarëve është tema: Njeriu, të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut (mbi 80% nxënës dhe 90% arsimtarë e konsiderojnë si interesante). Tema: Hulimtim i së drejtës ndërkombëtare humanitare, është më pak interesante edhe sipas arsimtarëve, edhe sipas nxënësve. Në fokus grupet si tema më interesante janë dalluar temat për të drejtat e njeriut dhe për Bashkimin Evropian.

NEVOJA PËR PËRMBAJTJE TË REJA NË PROGRAMIN

Sipas përgjigjeve të arsimtarëve në pyetësin për nevojën e mësimin të temave të reja/të tjera në edukatën qytetare, në programin duhet të përfshihen temat vijuese:

- ➔ Dukuri socio-patologjike (21 arsimtarë);
- ➔ Të drejta dhe obligime (12 arsimtarë);
- ➔ Ekologji (10 arsimtarë).

Edhe në diskutimet në fokus grupe parashtroeshin ide të ngjashme: *“tema nga përditshmëria; si funksionojnë shtetet; për korrupsionin në organet shtetërore; ndikimi i bashkësisë ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve; gruaja në shoqërinë*. Disa nga pjesëmarrësit bënë të ditur në ngjashmërinë e qëllimeve dhe të një pjese të përmbajtjeve me lëndën Etikë dhe lëndën zgjedhore Qytetërim evropian.

Nxënësit u pyetën: *A ka tema që tani nuk mësohen, ndërsa do të dëshiroje të përfshihen në lëndën Edukatë qytetare?* 19% e nxënësve të anketuar (105 nxënës) janë përgjigjur se ka. Janë propozuar temat vijuese:

- ➔ Dukuri negative shoqërore (15);
- ➔ Për politikë dhe pushtet (13);
- ➔ Lumturi (7).

Disa nga këto tema janë pjesë e programit mësimor, por me siguri jo në këtë vëllim që do të donin nxënësit që i kanë propozuar.

Në diskutimet në fokus grupet shumica e nxënësve konsiderojnë se nuk ka tema të tilla për shkak se *“gjithçka është e përfaqësuar; i ka të gjitha temat e nevojshme”* ose për shkak se *“do të nevojitet nxënie plus”*. Në një nga fokus grupet në të cilat u zhvillua një diskutim më i gjerë lidhur me këtë çështje p.sh. *“situatat me kriminalitetin dhe korrupsionin e autoriteteve në më shumë shtete; më shumë për rrethanat lokale, e jo të kemi temë të madhe si e drejta ndërkombëtare humanitare që nuk e kuptojmë”*.

KONSTATIME QË KANË TË BËJNË ME MENDIMET PËR PROGRAM MËSIMOR

- ➔ Nxënësit mendojnë se duhet të mësohet edukata qytetare për shkak se mësohen përmbajtje që u janë të dobishme në jetë. Në lëndën mësohen përmbajtje që ata kryesisht kanë pritur se do t'i mësojnë. Shumica e tyre i konsiderojnë të rëndësishme dhe interesante. Më interesante u janë të drejtat e njeriut, ndërsa më pak interesante për pushtetin dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Mirëpo, ata në numër më të madh konsiderojnë se disa nga temat që nuk u janë interesante janë të rëndësishme që t'i mësojnë. Nuk kanë shumë tema rreth të cilave do të pajtoheshit se duhet të mësohen, e nuk janë pjesë e përmbajtjeve në këtë lëndë.
- ➔ Për numrin më të madh të temave arsimtarët konsiderojnë se janë të rëndësishme në përgjithësi, ndërsa edhe për nxënësit. Për më të rëndësishme i konsiderojnë: Të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut, Demokracia dhe shoqëria civile, Konflikti dhe Media. Ata konsiderojnë se këto tema janë më interesante dhe në përgjithësi edhe për nxënësit. Më së paku të rëndësishme dhe interesante e konsiderojnë temën: E drejta ndërkombëtare humanitare. Perceptimi i tyre për përmbajtjet, marrë në përgjithësi është më pozitiv ai i nxënësve. Një numër i vogël i arsimtarëve kanë propozim për përmbajtje të reja në programin. Tri të katërtat e arsimtarëve konsiderojnë se një orë nuk mjafton për realizimin e përmbajtjeve.
- ➔ Emri i lëndës edhe sipas arsimtarëve edhe sipas nxënësve është adekuat me përmbajtjet



2. PERCEPTIME PËR REALIZIMIN E MËSIMIT

2.1. UDHËZIME DIDAKTIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Në programin mësimor janë dhënë edhe udhëzimet themelore didaktike për realizimin e tij. Në to qëndron se “Me programin mësimor nga edukata qytetare janë parashikuar mundësi për punë të individualizuar dhe grupe të nxënësve që kontribuon në pavarësi në të menduarit dhe zbatim të diturive dhe aftësive të përvetësuar në aktivitete hulumtuese... Natyra e lëndës mësimore parashikon punë të përgatitur mirë grupe të nxënësve në mësim që të mbështetet aftësia e çdo nxënësi për të qenë inventiv... të organizohet mësim ndërveprues...” (Programi mësimor nga Edukata qytetare, faq. 4)¹⁵

Në pjesën e programeve mësimore në të cilën janë dhënë aktivitete dhe metoda të rekomanduara rekomandohen metoda të ndryshme të punës: grupe dhe të pavarur; tekst metoda, punëtori, demonstrim, simulim, debat, prezantim, hulumtim. Aktivitetet e rekomanduara kërkojnë nivel të ndryshëm të angazhimit kognitiv të nxënësve, kujtesë, kuptim, analizë, zbatim dhe mund t'i orientojnë arsimtarët drejt organizimit të mësimin përmes përfshirjes aktive të nxënësve dhe zhvillimit të mendimit kritik të ata.

2.2. PERCEPTIM PËR MËSIMIN DHE MBËSHTETJEN E NXËNIES

Perceptime për atë se si realizohet mësimi dhe si arsimtarët e mbështesin nxënien e nxënësve nga edukata qytetare janë bërë në bazë të: (1) përgjigjeve të arsimtarëve në pyetjet në pyetësor dhe diskutimit për realizimin e mësimin në fokus grupe me arsimtarë dhe (2) përgjigjeve të nxënësve të klasës së 8-të dhe 9-të në pyetjet në pyetësorin për nxënës dhe në fokus grupet me nxënës.

Perceptimet për realizimin e mësimin janë grupuar në dy fusha tematike:

MËNYRË E HULUMTIMIT

Të dhënat për realizimin e mësimin dhe mbështetjen e nxënies janë fituar në bazë të pyetësorit për arsimtarë dhe 2 pyetje për diskutim në fokus grupet, dhe 8 pyetje nga pyetësori për nxënës dhe 5 pyetje për diskutim në fokus grupet me nxënës.

Pyetjet në pyetësorët ishin të tipit të mbyllur dhe të hapur. Nga një pyetje në pyetësorin për arsimtarë dhe nxënës ishte e grumbulluar.


2.2.1. METODA TË REALIZIMIT TË MËSIMIT

Lidhur me atë se si realizohet mësimi dhe sa shpesh përdoren metodat dhe teknikat e ndryshme që janë rekomanduar në programin mësimor janë pyetur edhe arsimtarët edhe nxënës. Përgjigjet e tyre janë paraqitur në Grafikonin nr. 3.

Sipas përgjigjeve edhe të nxënësve edhe të arsimtarëve, mësimi nga edukata qytetare është mjaft e llojllojshme në aspektin metodik. Megjithatë, në të shumtën e rasteve (çdo orë ose në shumicën e orëve) përdoret metoda monologe (ligjërojnë arsimtarët) dhe tekst metoda (nxënësit lexojnë nga librat shkollor). Krahas tyre mjaft shpesh përdoren: analiza e situatave dhe ngjarjeve, zgjidhje e situatave problematike dhe aktivitete hulumtuese. Një numër i madh i arsimtarëve janë përgjigjur edhe se shpesh japin pyetje/detyra nga nivelet më të larta të kompleksitetit kognitiv.

Për përdorimin e shumicës së metodave dhe teknikave aktive ekziston mospërputhje e caktuar në përgjigjet e arsimtarëve dhe nxënësve. Me fjalë tjera, arsimtarët në përqindje më të madhe përgjigjen se i përdorin në çdo orë ose në më shumë orë, derisa perceptimi i nxënësve është se ato përdoren më rrallë. Më të mëdha janë dallimet kur bëhet fjalë për punën në grupe dhe çifte të vogla, diskutime dhe debate në tema të propozuara nga nxënësit dhe përdorim të ueb kuesteve. Këto, sipas nxënësve, përdoren rrallë.

¹⁵ Edukatë qytetare – program mësimor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës <http://bro.gov.mk/docs/osnovno-obrazovanie/VII%20oddelenie/Microsoft%20Word%20-%20gragansko%20obrazovanie.pdf>



Grafikoni 3. Shpeshësia e përdorimit të metodave dhe teknikave të caktuara në mësim



Krahas pyetjes së metodave në mësim edhe dy pyetje nga pyetësi për nxënës kishin të bëjnë me realizimin e mësimin nga edukata qytetare. Në njërin kërkoheshin disa “mënyra (më frekvente) të nxënies” së edukatës qytetare t’i radhisin sipas asaj se sa duan të mësojnë në këtë mënyrë, ndërsa në të dytën të përgjigjen se sa shpesh u janë interesante orët e edukatës qytetare.


Metoda të radhitura më së larti janë ligjërata dhe diskutim/punë në grupe. Fitohet përshtypje se nxënësit janë përshtatur me metodat e mësimin që përdoren më shpesh. Dukshëm më pak duan të mësojnë në mënyrat që kërkojnë më shumë punë të pavarur dhe angazhim më të madh personal.

TABELA 4. CILAT METODA TË NXËNIES I PREFEROJNË NXËNËSIT

MËNYRA E NXËNIES	% E NXËNËSVE QË KANË DHËNË RANGUN NUMËR 1*	RANG MESATAR
LIGJËRATA	38,6	2,4
DISKUTIM/PUNË NË GRUPE	25,1	2,4
PUNË E PAVARUR NË ORË	12,9	3,1
PUNË ME KOMPJUTER	10	3,4
LOJË ROLESH, SIMULIME, LOJËRA	13,5	3,6

* rang nr. 1 ka të bëjë me mënyrën që ju pëlqen më së shumti, ndërsa 5 që ju pëlqen më së paku

Sipas mendimit të thuajse dy të tretave të nxënësve orët e edukatës qytetare u janë interesante thuajse gjithmonë, ndërsa për një të tretën u janë interesante ndonjëherë. Një numri shumë të vogël të nxënësve orët e edukatës qytetare u janë më shpesh të mërzitshme.



Grafikoni 4. A u janë nxënësve interesante orët e Edukatës qytetare

Nga ana tjetër, në fokus grupet nxënësit përmendnin se mësimi nga edukata qytetare do të mund të ishte më interesante nëse “vjen dikush të na mbajë ligjërata; të ketë më shumë vizita në institucione; të ketë simulime; prezantime; fotografi, video, lojë rolesh dhe ndërveprim; të ketë projekte; të bëjmë prezantime. Arsimtarja të ketë dëshirë të na interesojë; Të ketë hulumtim, të mos kërkohet vetëm të përshkruajmë; Të ketë debate që të mund të themi lirisht se çfarë mendojmë, ndërsa kjo është më e rëndësishme”. Nxënësit në fund i kanë përmendur qasjet që me siguri i kanë shijuar në ndonjërin prej orëve ose që kanë dëgjuar për to.

2.2.2. MBËSHTETJE E NXËNIES

Mësimi bashkëkohor parapëlqen që gjatë orës të ndodhë pjesa më e madhe e nxënies, veçanërisht në lëndët siç është edukata qytetare të cilat qëllimet në masë të madhe kanë të bëjnë me formimin e qëndrimeve dhe ndërtimin e sistemit të vlerave. Prandaj, një numër i madh i pyetjeve kanë të bëjnë me mbështetjen e nxënies.

SQARIM I NOCIONEVE QË MËSOHEN

Në programin nga edukata qytetare për klasën e tetë dhe të nëntë janë përmendur gjithsej 170 nocione që nxënësit duhet t’i përvetësojnë. Me numrin më të madh prej tyre nxënësit me siguri do të takohen për herë të parë. Këto në të shumtën e rasteve nuk janë nocione të thjeshta që kuptohen dhe përkufizohen lehtë. Si rezultat i kësaj, është e rëndësishme që në orë arsimtari t’u ndihmojë nxënësve të kenë kuptimin e saktë të të gjithave ose shumicës së nocioneve që hasen në ndonjë temë, veçanërisht meqë për shumicën prej tyre prindërit në shtëpi nuk mund t’u ndihmojnë nxënësve që t’i kuptojnë.

Për atë nëse të gjitha pyetjet dhe nocionet që kanë të bëjnë me përmbajtjen e njësive mësimore arsimtari i sqaron gjatë orës janë pyetur edhe arsimtarët edhe nxënësit.

Sipas përgjigjeve të numrit më të madh të arsimtarëve (81%) dhe nxënësve (73%) arsimtarët gjithmonë në orë i sqarojnë nocionet dhe pyetjet që kanë të bëjnë me përmbajtjen mësimore. Të tjerët janë përgjigjur se rasti i tillë është shumë i shpeshtë, ndërsa është i vogël numri i nxënësve që janë përgjigjur se kjo ndodhë ndonjëherë ose më rrallë.

TABELA 5. SA SHPESH NOCIONET DHE PYETJET SQAROHEN GJATË ORËS.

SHPESHTËSI	NXËNËS		ARSIMTARË	
	NUMËR	%	NUMËR	%
GJITHMONË	394	72,7	186	81,2
SHUMË SHPESH	114	21,0	38	16,6
RRALLË	8	1,5	3	1,3
NDONJËHERË	24	4,4	2	0,9
ASNJËHERË	2	0,4	0	0,0
GJITHSEJ	542*	100,0	229*	100,0

* janë marrë parasysh vetëm të anketuarit që i janë përgjigjur pyetjes

Disa nxënës kanë vërejtur se *“arsimtari është shumë i lumtur kur i parashtroni pyetje dhe përgjigjet me përkushtim të madh”, ndërsa ka edhe arsimtarë që “bërtasin dhe marrin në pyetje”*. Thujse të gjithë, 97% e nxënësve, janë përgjigjur se janë të lirë gjatë orës të pyesin arsimtarin për atë që nuk e kanë të qartë. Nga ana tjetër, nxënësit dhe arsimtarët bëjnë të ditur se fondi i orëve është i vogël dhe për shkak të kësaj nuk ka kohë të mjaftueshme për të sqaruar disa gjëra për të cilat nxënësit shprehin interesim. Mirëpo, ka arsimtarë që pas orës mbeten për t’ua sqaruar nxënësve atë që nuk e kanë të qartë.

Pas nxënies së përmbajtjeve mësimore ose leximit të diçkaje lidhur me ato që e kanë mësuar nxënësit mund të kenë nevojë për sqarime plotësuese të asaj që e kanë mësuar. Prandaj nevojitet të kenë mundësi, sa është e mundshme më shpejtë, në ndonjëherë prej orëve të ardhshme t’i sqarojnë gjërat e paqarta. Edhe sipas përgjigjeve të nxënësve edhe sipas përgjigjeve të arsimtarëve më shumë se gjysma e arsimtarëve i sqarojnë gjithmonë gjërat e paqarta në orët e radhës, ndërsa rreth një e treta e bëjnë këtë shumë shpesh. Rreth 10% e arsim-

tarëve gjithmonë i sqarojnë gjërat që nuk i kanë pasur të qarta nxënësit edhe pasi që i kanë mësuar mësimet në shtëpi.

TABELA 6. SA SHPESH SQAROHEN NOCIONET DHE PYETJET NË ORËT E ARDHSHME

SHPESHTËSI	NXËNËS		ARSIMTARË	
	NUMËR	%	NUMËR	%
GJITHMONË	302	55,7	135	59,0
SHUMË SHPESH	169	31,2	75	32,8
RRALLË	18	3,3	13	5,7
NDONJËHERË	51	9,4	4	1,7
ASNJËHERË	2	0,4	2	0,9
GJITHSEJ	542*	100,0	229*	100,0

* janë marrë parasysh vetëm të anketuarit që i janë përgjigjur pyetjes

Sipas përgjigjeve të fituara, numri më i madh i arsimtarëve gjithmonë ua sqarojnë nocionet dhe pyetjet që mësohen gjatë orës, ndërsa në masë pak më të vogël ua sqarojnë në njëherë prej orëve të ardhshme.

Për sqarim arsimtarët në të shumtën e rasteve përdorin shembuj nga përditshmëria, e më rrallë stuhi idesh, fjalor për fjalë të paqarta, vikipedi, skema.

PJESËMARRJE AKTIVE E NXËNËSVE

Në mësimin nga të gjitha lëndët pritet që nxënësit të mund të marrin pjesë aktive në aktivitetet e orës dhe të mund të shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre. Në edukatën qytetare pritet që kjo të jetë praktikë e rregullt në mësim, duke marrë parasysh faktin se nxënësit duhet të mësojnë jo vetëm përmes teorisë, por edhe përmes pjesëmarrjes aktive dhe praktikimit të shprehjes së lirë, pa qenë të kritikuar për këtë. Numri më i madh i arsimtarëve (78%) janë përgjigjur se gjithmonë mundësojnë shprehje të lirë të mendimeve në orë. Në fokus grupet përmendnin shembuj se si nxënësit janë ndjerë të lirë për të thënë se *“sipas asaj që u tha se çfarë është demokracia, Maqedonia është shtet që nuk funksionon sipas ligjeve”*. Sa do ta shprehin nxënësit mendimin e tyre varet edhe nga tema, ndërsa arsimtarët i nxisin që ta thonë mendimin e tyre përmes diskutimit për çështje aktuale. Disa arsimtarë bënë të ditur për fondin e vogël të orëve, ndërsa materiali është shumë voluminoz dhe *“nuk kemi kohë dhe hapësirë për pyetje dhe përgjigje”*.

Mirëpo, perceptimi i nxënësve nuk është aq i volitshëm. Vetëm pak më shumë se gjysma e nxënësve (57%)



kanë ndjenjën se mund të shprehin mendimin e tyre. Në një fokus grup nxënësit këtë e ilustruan me “Arsimtarja na ka thënë edhe nëse gabojmë me rëndësi është që të themi mendimin tonë”.

TABELA 7. SA SHPESH NXËNËSIT MUND TË SHPREHIN LIRSHËM MENDIMIN NË ORË

SHPESHTËSI	NXËNËS		ARSIMTARË	
	NUMËR	%	NUMËR	%
GJITHMONË	307	56,6	179	78,2
SHUMË SHPESH	158	29,2	36	15,7
RRALLË	32	5,9	10	4,4
NDONJËHERË	39	7,2	3	1,3
ASNJËHERË	6	1,1	1	0,4
GJITHSEJ	542*	100,0	229*	100,0

* janë marrë parasysh vetëm të anketuarit që i janë përgjigjur pyetjes

Një pjesë e nxënësve (29%) kanë ndjenjën se shpesh mund të shprehin mendimin e tyre, por jo gjithmonë. Ata kanë treguar shembuj kur kanë qenë të keqkuptuar “kur kanë përpunuar programe të dypartive”. Bashkë me të dhënë se 14% e nxënësve ndonjëherë ose gjithmonë kanë mundësi për shprehje të lirë të mendimit bën të ditur në demokracinë e pamjaftueshme në mësim të disa arsimtarë të edukatës qytetare.

Më i volitshëm është perceptimi i nxënësve lidhur me atë se sa arsimtarët i nxisin për pjesëmarrje aktive në orë: 75% konsiderojnë se arsimtarët i nxisin vazhdimisht, 20% i nxisin ndonjëherë, ndërsa 5% nuk i nxisin asnjëherë. Arsimtarët i nxisin nxënësit përmes metodave aktive që i përdorin (diskutim për shembuj, metoda ndërvepruese, punë me kompjuterë, pyetje nxitëse).

Në fokus grupet ata flitnin edhe për shembuj të arsimtarëve që nuk i nxisin për pjesëmarrje, por që lexojnë nga libri shkollor dhe pyesin.


Mbështetje në nxënien nxënësve të arsimit fillor pritet t’u japin edhe prindërit. Për ta bërë këtë me sukses, veçanërisht në lëndët siç është edukata qytetare, të cilën edhe vetë me siguri nuk e kanë mësuar, është me rëndësi që arsimtarët t’i informojnë se si punojnë në mësim dhe t’i nxisin për angazhim në nxënien e fëmijës së tyre, e ndoshta edhe në disa aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore që kanë të bëjnë me edukatën qytetare. Vetëm 57% e arsimtarëve janë përgjigjur se i informojnë dhe nxisin prindërit e nxënësve për angazhimin

e tyre. Ky është gjithsesi një numër i pamjaftueshëm i arsimtarëve.

NOTIMI

Në programin mësimor ka pak drejtime për notimin e të arriturave të nxënësve, por në mënyrë eksplicite bën të ditur në notimin formativ. Në hulumtimin se çfarë metodash dhe teknikash përdoren në notim është theksuar posaçërisht edhe për shkak se të gjitha hulumtimet e potencojnë notimin formativ si mjet të fuqishëm për nxitjen e nxënies. Krahas notimit, viteve të fundit, u është kushtuar vëmendje edhe trajnimeve dhe mbështetjes së arsimtarëve.

Sipas përgjigjeve të arsimtarëve, ata në të shumtën e rasteve në çdo orë ose në shumicën e orëve për notim të nxënësve e bëjnë këtë përmes përgjigjeve me gojë të pyetjeve dhe mbajtjen e shënimeve për këtë. Një numër i konsiderueshëm i arsimtarëve janë përgjigjur se mbajnë portofol për nxënësit. Ndonjëherë përdoren vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë.



Hulumtimet tregojnë¹⁶ se informacioni cilësor dhe me kohë kthyes është mënyra më e mirë e mbështetjes së nxënies.

Pak më shumë se gjysma (60%) e arsimtarëve janë përgjigjur se gjithmonë u japin nxënësve informacion kthyes për atë që e kanë mësuar mirë dhe që duhet ta përmirësojnë, ndërsa rreth një e treta (32%) këtë e bëjnë shumë shpesh. Përgjigjet e nxënësve bëjnë të ditur se nuk marrin aq shpesh informacion kthyes. Me fjalë tjera, vetëm 37% e nxënësve janë përgjigjur se gjithmonë marrin informacion të tillë, 39% marrin ndonjëherë, ndërsa të tjerët (24%) më rrallë.

¹⁶ Hattie J., (2009), *Visible Learning, A Synthesis of over 800 Meta-Analyses Relating to Achievement*, Routledge, London.

Përgjigjet krahasuese të nxënësve dhe arsimtarëve janë paraqitur në tabelën 5.

TABELA 8. SA SHPESH NXËNËSVE U JEPET INFORMACION KTHYES

SHPESHTËSI	NXËNËS		ARSIMTARË	
	NUMËR	%	NUMËR	%
GJITHMONË	197	36,7	135	60,3
SHUMË SHPESH	208	38,7	71	31,7
RRALLË	88	16,4	18	8,0
NDONJËHERË	32	6,0		
ASNJËHERË	12	2,2		
GJITHSEJ	537*	100,0	224*	100,0

* janë marrë parasysh vetëm të anketuarit që i janë përgjigjur pyetjes

- ➔ Programi mësimor rekomandon përdorimin e metodave të ndryshme ndërvepruese. Sipas përgjigjeve të nxënësve dhe arsimtarëve mësimi është i llojllojshëm në aspektin metodik ndonëse në të shumtën e rasteve përdoren metoda monologe dhe tekst metoda. Arsimtarët janë përgjigjur se shumicën e metodave aktive i përdorin më shpesh sesa që është perceptim i nxënësve.
- ➔ Numrit më të madh të nxënësve (2/3) orët e edukatës qytetare u janë interesante gjithmonë. Kur i kanë radhitur metodat e nxënies që më së shumti i preferojnë rangun më të lartë e kanë fituar ato që përdoren edhe më shpesh në mësim: ligjëratë dhe punë në grupe.
- ➔ Mbështetja e nxënies së nxënësve kur bëhet fjalë për sqarimin e përmbytjeve dhe nocioneve në orë sipas përgjigjeve të arsimtarëve është e rregullt dhe e shpeshtë, por sipas nxënësve jo mjaft e rregullt në orët e ardhshme.
- ➔ Numri më i madh i nxënësve kanë ndjenjën se arsimtarët i nxisin vazhdimisht për pjesëmarrje aktive, por të tjerët konsiderojnë se kjo ndodhë ndonjëherë.
- ➔ Të ndryshme janë perceptimet e arsimtarëve dhe të nxënësve për atë nëse gjithmonë mund të shprehin lirshëm mendimin, pa qenë të kritikuar. Pak më shumë se ¼ e arsimtarëve konsiderojnë se këtë e mundësojnë gjithmonë, derisa vetëm pak më shumë se gjysma e nxënësve kanë ndjesinë e tillë.
- ➔ Thuajse gjysma e arsimtarëve nuk i informojnë prindërit për punën në orët e edukatës qytetare dhe nuk i nxisin për t'u përfshirë në njëfarë mënyre.
- ➔ Përgjigjet bëjnë të ditur se thuajse një e katërta e nxënësve nuk marrin përgjigje përkatëse kthyesë që do t'i udhëzonte se si ta përmirësojnë nxënien, ndërsa instrumentet e notimit që janë përdorur më shpesh janë parashtrimi i pyetjeve me gojë dhe mbajtja e shënimeve.



3. PERCEPTIME TË LIBRAVE SHKOLLOR

3.1. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E LIBRAVE SHKOLLOR

Në përputhje me Ligjin për libra shkollor për arsim fillor dhe të mesëm, si dhe sipas Ligjit për arsim fillor, libri shkollor është mjet themelor mësimor dhe burim i diturisë për realizimin e qëllimeve edukativo-arsimore të programeve mësimore.

Librat shkollor përpilohen sipas programeve mësimore të lëndëve të caktuara nga Plani mësimor dhe sipas Konceptcionit për përpilimin e librit shkollor¹⁷.

Komisionet e recensionit të formuara nga Shërbimi pedagogjik bëjnë vlerësimin e librave shkollor në përputhje me Metodologjinë për vlerësimin e librave shkollor¹⁸ dhe me mendimin e fituar nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit për përputhje të dorëshkrimit për libër shkollor me programin mësimor, i propozojnë ministrit libër shkollor që i plotëson të gjitha kriteret.

Ndonëse, në këtë Konceptcion për përpilimin e librit shkollor nuk ka kapitull të veçantë me kriteret për përpilimin e librit shkollor të edukatës qytetare, megjithatë, janë dhënë kriteret themelore që duhet t'i plotësojë çdo libër shkollor për të qenë i vlerësuar dhe aprovuar për përdorim nëpër shkolla. Kështu, libri shkollor duhet t'i plotësojë kriteret vijuese:

- ➔ Përmbajtja e librit shkollor të jetë në përputhje me programin mësimor
- ➔ Mbështetja shkencore e përmbajtjeve (tekste plotësuese, pyetje dhe detyra, shtojca vizuale)
- ➔ Përshtatshmëri e librit shkollor me moshën e nxënësve
- ➔ Përmbajtjet e librit shkollor të kenë funksion edukativ, të nxisin raportin pozitiv ndaj shkencës, diturisë, identitetit kombëtar dhe qytetar, shumëkulturës dhe barazisë gjinore.

17 Konceptcion për përpilimin e librit shkollor, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, 2010. <http://bro.gov.mk/docs/Biro%20za%20obrazovanie%20-%20konceptcija%20za%20izrabotka%20na%20ucebnik%20mk%20-%20za%20na%20web.pdf>

18 Metodologjia për vlerësimin e librave shkollor, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, 2010

Për lëndën Edukatë qytetare ekzistojnë dy libra shkollor, "Edukatë qytetare për klasën e VII në arsimin tetëvjeçar" (klasa e VIII në arsimin nëntëvjeçar)¹⁹ dhe „Edukatë qytetare për klasën e VIII “ (klasa IX në arsimin nëntëvjeçar)²⁰.

LIBRI PËR KLASËN E TETË PËRMBAN TRI FUSHA KRYESORE

- ➔ Njeriu, të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut, duke mbuluar tema si: identitete, vlera, të drejta të njeriut, stereotipa dhe paragjykime, etj.;
- ➔ Demokraci dhe shoqëri civile, me tema: karakteristika të demokracisë, mënyra të qeverisjes në demokraci dhe të drejtat e njeriut, etj.;
- ➔ Bashkimi Evropian, me tema: institucione në BE, identitet evropian, Maqedonia si pjesë e BE-së, etj.

Libri shkollor për klasën e nëntë i përmban fushat vijuese:

- ➔ Pushtet (përkufizim, ndarje të pushtetit, kushtetutë dhe demokraci kushtetuese, etj.),
- ➔ Konfliktet (nocioni, lloje të konfliktit, zgjidhje e konflikteve,
- ➔ Hulumtim të së drejtës ndërkombëtare humanitare (krijimi i DNH-së, presion social, baza të DNH-së, DNH-ja dhe të drejtat e njeriut, sanksionimi i shkeljeve të DNH-së, etj.);
- ➔ Media (karakteristika të mediave masive, kulturë mediatike, etj.)

Temat në librat shkollor janë adekuate me temat në programin mësimor për klasën e tetë, gjegjësisht klasën e nëntë.

19 http://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/gragansko_obrazovanie_7_k1.pdf

20 http://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Gragjansko_8_mak.pdf

3.2. MENDIM PËR LIBRAT SHKOLLOR

MËNYRË E HULUMTIMIT

Mendime për librat shkollor te arsimtarët janë hulumtuar me 4 pyetje nga pyetësori për arsimtarët dhe 5 pyetje për diskutim në fokus grupet, ndërsa te nxënësit me 3 pyetje nga pyetësori për nxënës dhe 3 pyetje për diskutim në fokus grupet.

Pyetjet në pyetësorët ishin të llojit të mbyllur dhe të hapur.

3.2.1. DOBIA DHE PËRDORIMI I LIBRAVE SHKOLLOR

Pjesa më e madhe e arsimtarëve kanë deklaruar se **e përdorin librin shkollor në secilën orë, ndonëse nuk është i domosdoshëm gjatë tërë orës**, gjegjësisht i kombinojnë përmbajtjet me burime tjera. Përdorimi i librit shkollor, sipas tyre, është i domosdoshëm meqë pyetjet për testim ekstern formulohen në bazë të librit konkret shkollor.²¹ Nxënësit në përgjigjet e pyetjeve për metodat që përdoren në mësim dhe në fokus grupet konfirmojnë se e përdorin librin shkollor në secilën orë edhe atë gjatë pjesës më të madhe të orës, në të shumtën e rasteve përmes leximit dhe shqyrtimit të shembujve.

Për arsimtarët problem paraqet përzgjedhja dhe shpërndarja e librave shkollor. Sipas fjalëve të një arsimtari: *“Në nivel të aktivitetit përcaktohet me cilët nga librat e aprovuar shkollor do të punoni dhe më pas fitoni një libër tjetër shkollor që njëherësh na e çrregullon edhe mënyrën e planifikimit”*. Njëherësh, shpërndarja e librave shkollor mund të vonojë edhe deri dy tre muaj prej fillimit të vitit shkollor (sipas arsimtarëve nga fokus grupi në Tetovë).

Ndonëse libri shkollor në të shumtën e rasteve është resurs i dobishëm i orëve, megjithatë, rreth gjysma e arsimtarëve-pjesëmarrës të fokus grupeve konsiderojnë se **librat shkollor nuk ndihmojnë në realizimin e të gjitha qëllimeve nga programi mësimor**. Problemet i lokalizojnë në (1) mungesën e kohës për të përvetësuar materialin (2) stilin e lartë

të shkrimit, i cili pamundëson nxënësit ta kuptojnë tërësisht materialin, (3) „ngjashmëria“ e informacioneve që i „refuzon“ nxënësit, (4) shembujt e përmendur që nuk i janë përshtatur realitetit të nxënësve, por se janë marrë përsipër nga librat/materialet e huaja shkollore; ndonëse edhe (5) përkthimi joadekuat në disa pjesë të caktuara (për arsimtarët në gjuhën mësimore shqipe).

Në përputhje me këtë qëndrim janë edhe rezultatet nga anketa, sipas të cilës 61,2% e arsimtarëve të anketuar konsiderojnë se *“libri që përdoret nga Edukata qytetare u ndihmon nxënësve që t'i sqarojnë dhe t'i mësojnë përmbajtjet dhe nocionet që përpunohen gjatë orëve”*, derisa 38,8% nuk pajtohen me pohimin e lartpërmendur. Një pjesë e arsytimit mund të gjendet në përgjigjet në pyetjen – *“A ka në librat shkollor tema, përmbajtje, nocione, ilustrime që nuk janë adekuate ose gabimisht të paraqitura?”*, të cilës me po i janë përgjigjur madje 39,6% e arsimtarëve.

Në diskutimet në fokus grupet, arsimtarët bëjnë të ditur disa **tema dhe përkufizime që i konsiderojnë si problematike**. Konkretisht, përkufizimet për (1) stereotipa, (2) identitet, (3) stile të jetës, si dhe nocione dhe përkufizime në temat për:

- ➔ BE-ja dhe Maqedonia si pjesë e BE-së;
- ➔ Të drejtat e njeriut;
- ➔ E drejta ndërkombëtare humanitare.

Më tutje, si informacione jocilësore i përmendin temat për “qytetarët besnik”, për “kompromis”, si dhe temat për mediat. Përgjigjet bëjnë të ditur se disa aspekte problematike paraqiten në dy librat shkollor. Disa nga përkufizimet/nocionet e përmendura janë prezantuar në kornizën më poshtë.

²¹ Duke vërejtur se pyetjet për testimin ekstern nuk janë formuluar në mënyrë adekuate dhe vështirë mund të jepet përgjigjja e saktë, një arsimtar (pjesëmarrës në fokus grup në Tetovë) me vetiniciativë ka botuar Doracak për mësim nga Edukata qytetare.



NJË PJESË E SQARIMEVE TË NOCIONEVE DO TË MUND TË KLASIFIKOHEN SI TË GABUARA, SI PËR SHEMBULL:

„Qytetarët besnik i respektojnë ata që janë në pushtet në shoqëri. Ata gjithmonë janë të gatshëm t'i ndjekin rregullat dhe rregulloret në shoqëri edhe me çmimin që do të duhet patjetër të heqin dorë nga liritë e tyre“ (Edukatë qytetare për klasën e VIII, faq.14)

rfshira në konfliktin vullnetarisht heq dorë nga kërkesat e këtilla, atëherë themi se konflikti është zgjidhur përmes kompromisit.“ (Edukatë qytetare për klasën e VIII, faq. 39)

Një pjesë, edhe pse janë të sakta, mund të klasifikohen si konfuze, jo mjaft të sqaruara, si për shembull:

„Kur kuptimet e gabuara qëndrojnë me këmbëngulje përballë të dhënave dhe fakteve, atëherë flasim për stereotipa“ (Edukatë qytetare për klasën e VII, faq.39)

Nxënësit, po ashtu, konsiderojnë se libri shkollor nuk i ndihmon sa duhet në **sqarimin dhe mësimin e përmbajtjeve dhe nocioneve që përpunohen gjatë orëve**. Konkretisht, për pak më shumë se gjysmën e nxënësve (54%) të cilët janë përgjigjur në pyetësin, libri shkollor u ndihmon tërësisht, për 43% u ndihmon pjesërisht dhe për 3% nuk u ndihmon fare, prej çka rezulton se rreth gjysmës së nxënësve u nevojitet mbështetje plotësuese për përvetësimin e materialit nga libri shkollor.


Pjesa më e madhe e nxënësve të anketuar (78%) konsiderojnë se në librat shkollor nuk ka tema, përmbajtje, nocione, ilustrime që nuk janë adekuate ose të paraqitura gabimisht. Si rezultat i kësaj, në fokus grupet ata nuk japin përgjigje shumë të hollësishme lidhur me pyetjen **çfarë nuk u pëlqen te librat shkollor**. Megjithatë, një pjesë e tyre, si problematike i përmendin (1) Përmbajtjet që kanë të bëjnë me partitë politike dhe deputetët, për të cilët konsiderojnë se nuk përputhen me gjendjen reale në shtet; (2) Përmbajtjet për gjykatat ku përballen me shumë terme të reja; si dhe (3) rrjedhshmëria e përmbajtjeve që nuk janë të radhitura logjikisht. Në mënyrë plotësuese, nxënësit në fokus grupin në Tetovë si problematik e përmendin edhe faktin se në librat shkollor nuk mund t'i gjejnë përgjigjet në pyetjet për testimin ekstern.

3.2.2. NEVOJA E MATERIALEVE PLOTËSUESE PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE MËSIMORE

Në programin mësimor rekomandohet, por me siguri edhe aspektet e përmendura problematike nga librat shkollor kontribuojnë drejt asaj që arsimtarët të kërkojnë **materiale alternative për arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e mangësive nga librat shkollor**. Si rezultat i kësaj, arsimtarët në fokus grupet bëjnë të ditur se si material plotësues përdorin:

1. Doracakë që janë drejtpërdrejt të lidhur me temat nga libri shkollor, si për shembull Doracaku për Hulimtimin e së drejtës ndërkombëtare humanitare që e kanë marrë në trajnimet, ose nga ana tjetër që janë të lidhura në mënyrë indirekte me përmbajtje nga edukata qytetare, si për shembull punëtoritë nga Doracaku për arsim për shkathtësi jetësore dhe doracakët për zgjidhjen e konflikteve;
2. Informacione të arritshme në Internet (për shembull përmes Vikipedisë);
3. Dokumente konkrete që kanë rolin për të konkretizuar disa elemente të caktuara nga materiali, për shembull: Kushtetuta e RM-së, Statuti i komunës, Programi i partisë politike;
4. Materiale audio-vizuale si TV emisione, lajme.

Përgjigjet në pyetësin bëjnë të ditur se, sipas arsimtarëve, përmbajtjet digjitale janë përdorur nga pjesa më e madhe e arsimtarëve, më pas gazeta/revista, fotografi, vizatime, video/audio materiale dhe libra tjerë. Përgjigjet e nxënësve bëjnë të ditur në atë se burimet plotësuese të nxënies u nevojiten për t'i kuptuar më mirë përmbajtjet, ndërsa si të dobishme i përmendin përmbajtjet digjitale, libra tjerë, gazeta/revista, fotografi/vizatime dhe video/audio materiale (shiko Grafikonin 6 më poshtë). Në përgjithësi, përgjigjet e arsimtarëve dhe nxënësve janë kompatible, por bëjnë të ditur në faktin se arsimtarët do të mund të përdornin më shumë literaturë plotësuese gjatë mësimin, meqë nxënësit e konsiderojnë si të dobishme.



Grafikoni 6. Përdorimi dhe dobia e materialeve plotësuese: përgjigje të arsimtarëve dhe nxënësve

Në favor të kësaj është edhe e dhëna se ndonëse i konsiderojnë të dobishme, megjithatë, pjesa më e madhe e nxënësve bëjnë të ditur se nuk përdorin burime plotësuese për nxënie paralelisht me librin shkollor („...Punojmë në mënyrë monotone.“, „... e përdorim vetëm librin“), përderisa një pjesë e vogël bëjnë të ditur se gjithmonë përdorin burime tjera, për shembull video dhe internet materiale, si dhe gazeta dhe revista te përmbajtjet për mediat. Fitohet përshtypje se ka mosmarrëveshje lidhur me përdorimin e literaturës plotësuese, p.sh. një nxënës nga fokus grupi në Tetovë deklaroi se „e dimë se arsimtarët mund të ndëshkohen nëse përdoren revista. Këtë e di meqë nëna ime është mësuese“.

Duke marrë parasysh se një pjesë e konsiderueshme e arsimtarëve konsiderojnë se përdorimi i librit shkollor nuk mjafton për arritjen e të gjitha qëllimeve të parashikuara të mësimin, ata janë thuajse të njëzëshëm se **kanë nevojë për materiale plotësuese që do t'u ndihmonin ta ligjërojnë lëndën më mirë dhe në mënyrë më efikase**. Konkretisht, përmendin nevojën e:

- ➔ Doracakëve për arsimtar
- ➔ Linqe me përmbajtje nga Interneti
- ➔ Videomateriale

Veçanërisht theksohet nevoja për doracakë për realizimin e qëllimeve individuale nga programi, ku të njëjtat arrihen përmes metodave bashkëkohore ndërvepruese mësimore. Sipas fjalëve të një pjese të arsimtarëve, doracakët e këtillë janë shumë të dobishëm dhe praktik meqë ofrojnë modele konkrete për përpunimin e njëjësive të veçanta mësimore.

„Kisha rastin që të shfrytëzoj, broshurë nga projekti i USAID-it në të cilën kishte të dhëna për BE-në dhe të njëjtën e shfrytëzoja kur e realizoja temën me emër të njëjtë“.

„Do të na ishte shumë e dobishme që të kemi doracak me udhëzime për realizimin e secilit qëllim nga programi mësimor, me punëtori sipas shembullit të doracakut për shkathtësi jetësore ose nga ana tjetër doracaku për temën hulumtim të së drejtës ndërkombëtare humanitare“.

„(...) mendojmë në doracakët me ushtrime konkrete, pyetje, kuize, njësi të përpunuara metodike. Këto materiale doracaku do të mund të zhvilloheshin sipas asaj se si është përpunuar Doracaku nga Historia për klasën e gjashtë“.

KONSTATIM LIDHUR ME LIBRAT SHKOLLOR

Librat shkollor në mësimin nga Edukata qytetare përdoren rregullisht gjatë orëve, kohë pas kohë të plotësuar me materiale plotësuese.

Një pjesë e konsiderueshme e arsimtarëve konsiderojnë se struktura dhe përmbajtja e librave shkollor e kufizon realizimin e të gjitha qëllimeve nga programi mësimor.

Një pjesë e temave dhe nocioneve/përkufizimeve në librat shkollor konsiderohen si problematike dhe konfuze.

Një pjesë e rëndësishme e nxënësve konsiderojnë se libri shkollor nuk u ndihmon sa duhet në sqarimin dhe mësimin e përmbajtjeve dhe nocioneve që përpunohen gjatë orëve.

Arsimtarët kanë nevojë për materiale plotësuese, duke përfshirë: doracakë për zbatimin e përmbajtjeve mësimore, linqeve me përmbajtje nga interneti, video materiale.



4. PERCEPTIME PËR TRAJNIMET

4.1. TRAJNIME TË REALIZUARA

Trajnimi i arsimtarëve për realizim cilësor të mësimit është parashikuar me më shumë ligje: Ligjin për Byronë për Zhvillimin e Arsimit, Ligjin për arsimtarë në shkollat fillore dhe të mesme, Ligjin për Akademinë e arsimtarëve. Po ashtu, në ligjet është përkufizuar se numri i orëve për trajnim të arsimtarëve është bazë për zhvillimin e tyre profesional dhe në karrierë.

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e dispozitave në ligjet e përmendura janë miratuar në vitin 2015 dhe 2016, ndërsa një pjesë e dispozitave janë me zbatim të prolonguar, mund të merret parasysh vetëm kompetenca ligjore e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit për të bërë promovimin (trajnimin) e arsimtarëve për programet mësimore dhe të japë udhëzime didaktike për zbatimin e tyre.

Duke marrë parasysh se programet mësimore nga edukata qytetare janë miratuar në vitin 2008 dhe 2009, trajnimi i arsimtarëve që mbajnë mësim nga edukata qytetare është realizuar në vitet e njëjta, para fillimit të vitit shkollor 2008/2009 dhe vitit shkollor 2009/2010. Një numër i madh i arsimtarëve (34%) kanë më pak se 5 vite stazh pune ndaj nuk mund t'i ndjekin këto trajnime.

Gjatë periudhës prej vitit 2009 e deri sot, arsimtarët kanë pasur mundësinë të jenë në kontakt me këshilltarët nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit për konsultime për çështje nga mësimi dhe nxënia, por është fakt, se është i pamjaftueshëm trajnimi për tema nga fusha e edukatës qytetare, si dhe për metoda për realizimin e mësimit nga kjo lëndë mësimore.

Arsimtarët përmes shkollave të tyre, e edhe individualisht, ndjekin edhe trajnime nga projektet e aprovuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të cilat, kryesisht, kanë të bëjnë me zhvillimin e shkathësive për komunikim, metoda bashkëkohore të mësimit, multikulturalizëm, etj.. Lloji i këtillë i trajnimeve u ndihmojnë arsimtarëve në përmirësimin e një pjese të kompetencave të tyre si arsimtarë, por jo edhe në pjesën e kompetencave të tyre profesionale, si arsimtarë të edukatës qytetare.

4.2. TRAJNIME TË NDJEKURA DHE NEVOJA PËR TRAJNIME DHE MBËSHTETJE PROFESIONALE

MËNYRA E HULUMTIMIT

Mendime për trajnimet të arsimtarët janë hulumtuar me 3 pyetje nga pyetësi për arsimtarë dhe 3 pyetje për diskutim në fokus grupe. Një pyetje ishte e llojit të mbyllur (me plotësim), ndërsa dy ishin të llojit të hapur.

Pyetjet kishin të bëjnë me trajnimet që i kanë ndjekur dhe nevojat për trajnime.

Më pak se gjysma e arsimtarëve të anketuar (43,6%) janë përgjigjur se kanë ndjekur trajnim për mësimin nga Edukata qytetare në 5 vitet e fundit. Megjithatë, trajnimet e përmendura kanë të bëjnë me disa fusha të caktuara të ngushta nga programi ose jashtë programit, por që kanë të bëjnë me lëndën.

Një pjesë e arsimtarëve-pjesëmarrës në fokus grupet kanë theksuar se kanë ndjekur **trajnim me përmbajtje nga fusha e antikorrupsionit**, të realizuar nga Komisioni antikorrupsion, me arsyetimin se përmbajtjet do të jenë pjesë e programit mësimor për Edukatë qytetare.²²

Përmendet edhe trajnimi për **Hulumtim të së drejtës ndërkombëtare humanitare**, që është realizuar para më shumë se 5 viteve, por vlerësohet si veçanërisht i dobishëm për shkak të mënyrës së zellshme të prezantimit të përmbajtjeve dhe shembujve konkret se si të realizohen qëllime nga programi mësimor.

Arsimtarët janë thujse të njëzëshëm se u nevojitet mbështetje për forcimin e shkathësive të tyre për realizim të suksesshëm të mësimit nga Edukata qytetare. Si mekanizma më të domosdoshëm për realizimin e këtij qëllimi i përmendin:

- ➔ Trajnime plotësuese (140 arsimtarë që janë përgjigjur në pyetësin dhe numri më i madh i pjesëmarrësve në fokus grupet), dhe
- ➔ Bashkëpunimi me arsimtarë tjerë dhe ekspertë-këshilltarë,

²² Një pjesë e arsimtarëve shprehin rezerva se këto përmbajtje duhet të jenë të përfshira si pjesë e programit.

Lidhur me nevojat konkrete për trajnime, arsimtarët shprehin më së shumti nevojë për **trajnime për përdorimin e metodave ndërvepruese të mësimit, si dhe ushtrime konkrete për realizimin e përbajtjeve nga libri shkollor përmes teknikave bashkëkohore mësimore.**

„Më të dobishme për ne janë trajnimet në të cilat prezantohen format ndërvepruese të punës: trajnime, lojë rolesh, simulime. Është me rëndësi që gjatë trajnimit të përpunohen përbajtje konkrete nga programet përmes aktiviteteve konkrete që nuk do të mund t'i zbatonim drejtpërdrejt në mësim“.

Në mënyrë plotësuese nevojiten edhe trajnime për përdorimin e internetit si resurs, metoda të notimit dhe rritje e të arriturve të nxënësve përmes mësimdhënies përkatëse, si dhe trajnime profesionale për përbajtjet mësimore, për shkak se, siç bën të ditur një arsimtar *“një pjesë prej neve nuk janë sociologë dhe kemi nevojë për trajnime për zhvillimin tonë profesional lidhur me përbajtjet e vetë lëndës mësimore“.*

Nevojat përfshijnë edhe bashkëpunim me aktivet profesionale nga grupi shoqëror i lëndëve, bashkëpunim në nivel të më shumë shkollave dhe përdorim të ekspertëve-këshilltarë nga kjo fushë.

„Duhet të organizohen projekte në të cilat do të ishim përfshirë, do të mësonim prej njëri-tjetrit, do të shkëmbejm përvoja“.

Si sfida plotësuese gjatë realizimit të mësimit nga Edukata qytetare në pyetësorin përmenden: libra joadekuat shkollor (135 arsimtarë), mungesë e literaturës profesionale (89 arsimtarë), dhe fondi i vogël i orëve (68 arsimtarë). Si rezultat i kësaj, si mjete për mësim më efektiv përmenden:

- ➔ Libra të përmirësuar shkollor,
- ➔ Literaturë plotësuese profesionale, dhe
- ➔ Rritje të fondit të orëve.

KONSTATIME LIDHUR ME TRAJNIMET:

- ➔ Gjatë pesë viteve të kaluara një pjesë e arsimtarëve nuk kanë ndjekur trajnim që ka të bëjë me lëndën Edukatë qytetare.
- ➔ Shumicës u janë të domosdoshme trajnimet për përdorimin e metodave ndërvepruese në mësim, si dhe ushtrime konkrete për realizimin e përbajtjeve nga libri shkollor përmes teknikave bashkëkohore mësimore.
- ➔ Përmenden edhe nevoja për trajnime për përdorimin e internetit si resurs, metoda të notimit dhe rritje e të arriturve të nxënësve përmes mësimdhënies përkatëse, si dhe trajnime profesionale për përbajtjet mësimore.
- ➔ Arsimtarët përmenden edhe nevojën e bashkëpunimit me kolegët në nivel të aktiveve profesionale, si dhe mbështetje nga këshilltarët.

5. PERCEPTIME PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE TË MËSIMIT

5.1. PËRKUFIZIM I QËLLIMEVE TË PROGRAMIT MËSIMOR

Në programet mësimore nga Edukata qytetare janë përkufizuar qëllime për lëndën në përgjithësi (për dy vitet e mësimit) dhe qëllime më konkrete për klasën e tetë, gjegjësisht të nëntë.

Nëse analizohen programet mësimore se si zhvillohen në dy klasat e mësimit, mund të vërehet se qëllimet zhvillimore të dhëna për periudhën (klasa VIII-IX) kanë të bëjnë vetëm me programin mësimor për klasën e tetë, derisa qëllimet e përfshira me programin mësimor në klasën e nëntë nuk kanë të bëjnë me qëllimet zhvillimore.

Po ashtu, ekziston përfaqësim i pabarabartë i qëllimeve dhe temave të caktuara në raport me tjera (për shembull, përfaqësim tepër i madh i temës Hulumtim të së drejtës ndërkombëtare humanitare në klasën e nëntë).

Pjesa më e madhe e qëllimeve janë në nivel të diturisë (*"të njoftohet...t'i zgjerojë dituritë..") dhe kuptimit ("të kuptojë..., të mësojë..., të dijë..., të dallojë lidhshmërinë..., të sqarojë), ndërsa një pjesë më e vogël në nivel të zbatimit ("të zbulojë shembuj...të aftësohet, të diskutojë..., të formojë qëndrime..., të tregojë gatishmëri...).*

5.2. ARRITJE TË QËLLIMEVE TË MËSIMIT

MËNYRË E HULUMTIMIT


Mendime për arritjen e qëllimeve të mësimit janë hulumtuar me tri pyetje nga pyetësi për arsimtarë dhe pesë pyetje nga pyetësi për nxënës. Në fokus grupet, arsimtarët i përgjigjeshin një pyetjeje për diskutim.

Ky hulumtim nuk ishte fokusuar në qëllimet në programin mësimor dhe arritjen e tyre, por një pjesë e pyetjeve për t'u sqaruar më mirë konteksti i realizimit të mësimit kishin të bëjnë edhe me ta.


Përgjigjet e arsimtarëve për nivelin e kontributit të programit mësimor për **aftësimin e mirëfilltë të nxënësve për veprim qytetar** të shprehur në shkalloren 10 shkallëshe tregojnë se më shumë se gjysma e arsimtarëve (59%) e konsiderojnë mesatarisht të lartë (vlerësuar prej 6-8 në shkalloren 1-10), derisa 24% e konsiderojnë të lartë (vlerësuar me 9 dhe 10).

Shumica e arsimtarëve (75,6%) konsiderojnë se **lënda Edukatë qytetare u ndihmon numrit më të madh të nxënësve që t'i arrijnë qëllimet e programit mësimor** (t'i kuptojnë problemet me të cilat përballet bashkësia (shkolla dhe bashkësia e lokale), të dallojnë zgjidhje për problemet dhe të përfshihen në aktivitete të bashkësisë), derisa një numër më i vogël janë përgjigjur se këto qëllime arrihen vetëm te një numër i vogël i nxënësve (Shiko Grafikonin 7).

Në pyetjen e njëjtë që u është parashtruar nxënësve, rreth gjysma e nxënësve të anketuar janë përgjigjur se u ndihmon shumë, më pak se gjysma se u ndihmon ndonjëherë, ndërsa një pjesë e vogël se nuk u ndihmon (shiko Grafikonin 8). Duke marrë parasysh se pyetjet janë shumështresore, është e mundshme që nxënësit të mbivlerësojnë programin si të dobishëm lidhur me disa aspekte, ndërsa më pak të dobishëm në aspekte tjera.



Grafikoni 7. A u ndihmon Edukata qytetare nxënësve tuaj që t'i kuptojnë problemet me të cilat përballet bashkësia, të dallojnë zgjidhje të problemeve dhe të përfshihen në aktivitete të bashkësisë?



Grafikoni 8. A të ndihmon lënda Edukatë qytetare që t'i kuptosh problemet me të cilat përballet bashkësia në të cilën mëson dhe jeton, të mendosh për zgjidhje të problemeve, të përfshihesh në aktivitete të bashkësisë lokale?

Ndonëse në mënyrë eksplicite është përmendur si qëllim i programit nga edukata qytetare konsiderohet se angazhimi shoqëror është mënyra më e mirë e nxënies së një pjese të përmbajtjeve nga edukata qytetare, ndërsa është një nga qëllimet e përgjithshme të arsimit²³. Thujse 40% e nxënësve janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen se a kanë marrë pjesë në punë publike/shoqërore, pjesëmarrje vullnetare në shkollë ose jashtë shkollës. Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël (72 nxënës) kanë përmendur shembuj konkret (Aksione humanitare, aksione të organizuara nga Kryqi i Kuq) dhe Eko-aksione (39 nxënës).

²³ Koncepti për edukatë dhe arsim fillor nëntëvjeçar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Shkup 2007, faq. 71 - 73

Arsimtarët vlerësojnë se nxënësit janë aktiv në bashkësinë, edhe atë përmes:

- ➔ Sjelljes në shkollë, për shembull në situata të kërkimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre;
- ➔ Përfshirjes bashkë me prindërit e tyre në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në bashkësi përmes projekteve ekologjike, Projektit të USAID-it për integrim ndëretnik në arsim dhe projektit Forcim të bashkëpunimit shumetnik në komunat të mbështetur nga Fondacioni për fëmijë Pestaloci, projekteve në bashkëpunim me administratën komunale (zhvillim lokal ekonomik, urbanizëm, veprimtari komunale);
- ➔ Pjesëmarrjes në aktivitete jashtëmësimore që kanë të bëjnë me bashkëpunimin shoqëror kulturor me bashkësinë lokale, veçanërisht për festat e bashkësive të ndryshme etnike, kremtimet përfundimtare në shkollë, etj.

Arsimtarët, gjithashtu, përballet më vështirësi që ta ndajnë atë që mësohet në orë nga zhvillimet e përditshme politike në shtet me të cilat ndeshen nxënësit.

„Shumë shpesh na ndodhë që nxënësit të mos na besojnë në atë që e themi meqë janë të ngarkuar me informacione nga mediat dhe nga familja. Mua shpeshherë më pyesin: Arsimtar, çfarë flitni? Nuk është ashtu në vendin tonë... Ne duhet t'i mësojmë nxënësit 'si duhet', e jo 'si është' në vendin tonë dhe këtu hasim në problem”.

„Na brengos shumë fakti që nxënësit një gjë shohin se është duke ndodhur rreth tyre, ndërkaq diçka tjetër i mësojmë ne në shkollë”.

Këto kundërthënie që i përmendin arsimtarët, ndonëse përjetohen si vështirësi gjatë mësimin, megjithatë mund të paraqesin burim të mirë të zhvillimit të raportit kritik të nxënësve për vlerat qytetare si mënyrë për nxitjen e interesit për një temë të caktuar dhe fillimin e procesit të hulumtimit të së njëjtës.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke marrë parasysh se thujse gjysma e arsimtarëve (117) janë përgjigjur se përmes mësimin e kanë të rëndësishme që t'i zhvillojnë te nxënësit shkathtësitë e shekullit 21 (mendim kritik, tolerancë, respektim të vlerave demokratike).



„Përvetësim i shkathtësive për zgjidhje të pavarur të situatave dhe problemeve të caktuara me qëllim që të aftësohen për arsimimin dhe jetën e mëtejshme“.

„Të ndërtojnë identitetin personal, të respektojnë vetveten dhe para së gjithash t'i respektojnë diversitetet“.


Në mënyrë plotësuese, 68 arsimtarë kanë bërë të ditur se përpiqen të zhvillojnë te nxënësit ndjenjën e përshtatjes/përkatësisë në shoqëri dhe bashkësi.

„Zhvillim i mendimit kritik për përfshirje aktive në bashkësi.“

KONSTATIME LIDHUR ME ARRITJEN E QËLLIMEVE TË MËSIMIT:

- ➔ Shumica e arsimtarëve konsiderojnë se lënda Edukatë qytetare ndihmon numrin më të madh të nxënësve që t'i arrijnë qëllimet e programit mësimor.
- ➔ Sipas çdo nxënësi të dytë, lënda Edukatë qytetare u ndihmon që t'i arrijnë qëllimet e mësimit pjesërisht.
- ➔ Thuajse gjysma e nxënësve janë përgjigjur se kanë marrë pjesë në punë publike/shoqërore, punë vullnetare në shkollë ose jashtë shkollës.
- ➔ Arsimtarët vlerësojnë se nxënësit janë aktiv në bashkësinë përmes: pjesëmarrjes në aktivitete jashtëmësimore, përfshirje dhe zgjidhje të problemeve të bashkësisë, sjellje që bën të ditur në kërkimin e të drejtave.
- ➔ Arsimtarët përballen me vështirësi për të ndarë atë që mësohet në orë nga zhvillimet e përditshme politike në shtet me të cilat ndeshen nxënësit.
- ➔ Për një pjesë të konsiderueshme të arsimtarëve aspekti kryesor i mësimit është zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 (mendim kritik, tolerancë, respektim të vlerave demokratike) te nxënësit.





SHTOJCA

SHTOJCA 1.

LISTË E SHKOLLAVE NGA TË CILAT ËSHTË ZGJEDHUR EKZEMPLARI I NXËNËSVE

Nr. rend.	SHKOLLA	VENDI
1.	SHF Vrapçisht	Vrapçisht
2.	SHF Goce Dellçev	Manastir
3.	SHF Goce Dellçev	Shkup
4.	SHF Sando Masev	Strumicë
5.	SHF Goce Dellçev	Prilep
6.	SHF Vëllezërit Milladinov	Strugë
7.	SHF Qirili dhe Metodi	Kumanovë
8.	SHF Qirili dhe Metodi	Tetovë
9.	SHF Kërste Misirkov	Gjevgjeli
10.	SHF Krume Kepeski	Shkup
11.	SHF Kërste Petkov Misirkov	Bistricë
12.	SHF Nikolla Karev	Radovish
13.	SHF Mareshali Tito	Strumicë/Strumicë
14.	SHF Panajot Ginovski	Shkup
15.	SHF Pere Toshev	Dupjaçani/Dollneni
16.	SHF Vera Ciriviri Trena	Dollneni/Debreshte
17.	SHF Vuk Karaxhiq	Kumanovë
18.	SHF Aleksandar Zdravkovski	Jegunovc
19.	SHF Andreja Savevski Qiqish	Tetovë
20.	SHF Bratstvo Migjeni	Tetovë
21.	SHF Vidoe Podgorec	Strumicë/Strumicë
22.	SHF Goce Dellçev	f. Stençe, Bërvenicë
23.	SHF Goce Dellçev	Gostivar
24.	SHF Goce Dellçev	Shtip
25.	SHF Josip Broz Tito	Strugë
26.	SHF Zhivko Brajkovski	Shkup
27.	SHF Qirili dhe Metodi	Koçanë
28.	SHF Klimenti i Ohrit	Prilep
29.	SHF Mançu Matak	Prilep
30.	SHF Murat Llabunishti	Strugë

31.	SHF Gjorgji Sugarev	Manastir
32.	SHF Bllazhe Koneski	Veles
33.	SHF Hristijan Karposh	Kumanovë
34.	SHF Vëllezërit Ribar	Kumanovë
35.	SHF Stiv Naumov	Manastir
36.	SHF Refije Alievska	Strugë/Llabunishta
37.	SHF Kultura	Likovë
38.	SHF Bajram Shabani	Shkup
39.	SHF Bratstvo	Shkup
40.	SHF Naim Frashëri	Tetovë
41.	SHF Faik Konica	Gostivar
42.	SHF Nikolla Vapcarov	Shkup
43.	SHF Imri Elezi	Shkup
44.	SHF Bratstvo	Gostivar

SHTOJCA 2.

LISTË E SHKOLLAVE NË TË CILAT PUNOJNË ARSIMTARËT QË JANË PËRGGJIGJUR NË PYETËSORIN

Nr. rend.	SHKOLLA	VENDI
1.	11 Tetori	Bogovinë
2.	Goce Dellçev	Vinicë
3.	Dimkata Angellov Gaberot	Kavadar
4.	Kërste P. Misirkov	Manastir
5.	Krum Toshev	Shkup
6.	Todor Angellovski	Manastir
7.	Hristo Uzunov	Drugovë
8.	11 Tetori	Kumanovë
9.	11 Tetori	Urviç
10.	25 Maj	Shkup
11.	7 Marsi	Likovë
12.	Marko Cepenkov	Zelenikovë
13.	Avram Pisevski	Shkup
14.	Aleksandar Zdravkovski	Jegunovc
15.	Anton Zako Çajupi	Likovë
16.	Aco Shopov	Shkup
17.	Bajram Shabani	Kondovë
18.	Bllagoj Kirkov	Veles
19.	Bllazhe Koneski	Shkup
20.	Bllazhe Koneski	Veles
21.	Bllazhe Koneski	Prilep
22.	Vëllezërit Milladinov	Demir Hisar
23.	Vëllezërit Milladinov	Strugë
24.	Vëllezërit Milladinov	Probishtip
25.	Vëllezërit Milladinov	Shkup
26.	Vëllezërit Ramiz - Hamid	Shkup
27.	Vëllazërim-Bashkim	Shkup
28.	Bratstvo Migjeni	Tetovë
29.	Vëllazërim-Bashkim	Dibër
30.	Vaço Nikoleski	Ohër
31.	Vaço Përke	Dellçevë – Dellçevë
32.	Vaço Përke	Shtip
33.	Vasill Gllavinov	Veles
34.	Vera Jociq	Shkup
35.	Vera Kotorka	Kumanovë
36.	Vera Ciriviri-Trena	Debreshte
37.	Video Podgorec	Strumicë
38.	Vllado Tasevski	Shkup
39.	Vrapçisht	Vrapçisht
40.	Vuk Karaxhiq	Kumanovë

41.	Gj.K. Skënderbeu	Haraçinë
42.	Gjorgji Pulevski	Mavrovë
43.	Gjorgji Sugarev	Manastir
44.	Gjorçe Petrov - Shkup	Gjorçe Petrov
45.	Goce Dellçev	Konçe
46.	Goce Dellçev	Resnjë
47.	Goce Dellçev	Bërvenicë
48.	Goce Dellçev	Bosillovë
49.	Goce Dellçev	Shkup
50.	Goce Dellçev	Demir Hisar
51.	Goce Dellçev	Manastir
52.	Goce Dellçev	Shtip
53.	Goce Dellçev	Negotinë
54.	Goce Dellçev	Ilinden
55.	Goce Dellçev	Gostivar
56.	Goce Dellçev	Vinicë
57.	Goce Dellçev	Aerodrom
58.	Goce Dellçev	Prilep
59.	Goce Dellçev	Stençe
60.	Dame Gruiev	Strumicë
61.	Dame Gruiev	Strumicë
62.	Dame Gruiev	Shën Nikollë
63.	Dame Gruiev Manastir	Manastir
64.	Dane Krapçev	Shkup
65.	Debërca	Debërc
66.	Dedo Iljo Maleshevski	Berovë
67.	Dençe Dejanoski	Mavrovë- Rostushë
68.	Dervish Cara	Bogovinë
69.	Dimitar Vllahov	Shtip
70.	Dimitar Pop Georgiev – Berovski	Shkup
71.	Dimkata A. Gaberot	Kavadar
72.	Dimo Haxhi Dimov	Karposh
73.	Dimçe Angellov- Gaberot	Demir Kapi
74.	Ditura	Saraj
75.	Dr. Trifun Panovski	Manastir
76.	Draga Stojanovska	Shkup
77.	Drita	Tetovë
78.	Edinstvo	Strugë
79.	Emin Duraku	Shkup
80.	Zhivko Brajkovski	Shkup
81.	Zhivko Çingo	Ohër
82.	Ibrahim Temo	Zhelinë
83.	Ismail Qemali	Dollneni
84.	Istikball	Tetovë
85.	Jan Amos Komenski	Shkup
86.	Jonçe Smugreski	Krivogashtan

87.	Josip Broz Tito	Strugë
88.	Josip Broz Tito	Mavrovë
89.	Karposh	Kumanovë
90.	Qirili dhe Metodi	Tetovë
91.	Qirili dhe Metodi	Bogdanci
92.	Qirili dhe Metodi	Shkup
93.	Qirili dhe Metodi	Shën Nikollë
94.	Klimenti i Ohrit	Prilep
95.	Klimenti i Ohrit	Obleshevë
96.	Klimenti i Ohrit	Gjevgjeli
97.	Kole Kaninski	Manastir
98.	Kole Nedellkovski	Shkup
99.	Kongresi i Manastirit	Kumanovë
100.	Koço Racin	Dojran
101.	Koço Racin	Kratovë
102.	Koço Racin	Ohër
103.	Koço Racin	Vinicë
104.	Koço Racin	Shkup
105.	Koço Racin	Kumanovë
106.	Koço Racin	Kratovë
107.	Koço Racin	Ivanjevc
108.	Kërste Misirkov	Shkup
109.	Kërste Misirkov	Gjevgjeli
110.	Kërste Petkov Misirkov	Radovish
111.	Kërste Petkov Misirkov	Koçanë
112.	Krume Kepeski	Shkup
113.	Kuzman Josifovski – Pitu	Shkup
114.	Kuzman Shapkarev	Shkup
115.	Llazo Angellovski	Shkup
116.	Liria	Çashkë
117.	Luigj Gurakuqi	Zhelinë
118.	Manush Turnovski	Novosellë
119.	Marko Cepenkov	Shkup
120.	Mareshali Tito Murtinë	Strumicë
121.	Metodi Mitevski - Brico	Llozovë
122.	Mirçe Acev	Shkup
123.	Mite Bogoevski	Resnjë
124.	Mustafa Kemal Ataturk	Gostivar
125.	Naim Frashëri	Vrapçisht
126.	Naim Frashëri	Studenica
127.	Naum Naumovski Borçe	Shkup
128.	Nikolla Vapcarov	Shkup
129.	Nikolla Karev	Radovish
130.	Nikolla Karev	Koçanë
131.	Nikolla Petrov-Rusinski	Rusinovë
132.	Nuri Mazari	Strugë

133.	Njegosh	Shkup
134.	Orhan Xhemaili	Strugë
135.	Orce Nikollov	Radovish
136.	SHF Malina Pop Ivanova	Koçanë
137.	SHF Tefejuz	Shkup
138.	Pashko Vasa	Shkup
139.	Petar Pop Arsov	Shkup
140.	Petre Pop Arsov	Bogomillë
141.	Peco Daskallot	Dollneni
142.	Rade Kratovçe	Koçanë
143.	Rajko Zhinzifov	Shkup
144.	Rajko Zhinzifov	Çair
145.	Rampo Levkata	Prilep
146.	Risto Kërpe	Shkup
147.	Risto Shuklev	Gjevgjeli
148.	Said Najdeni	Dibër
149.	Sami Frashëri	Bogovinë
150.	Shën Qirili dhe Metodi	Shkup
151.	Shën Qirili dhe Metodi	Koçanë
152.	Shën Qirili dhe Metodi	Bosillovë
153.	Shën Qirili dhe Metodi	Veles
154.	Shën Klimenti i Ohrit	Ohër
155.	Shën Klimenti i Ohrit	Strugë
156.	Simçe Nastovski	Jegunovc
157.	Sllavko Llumbarkovski	Novaci
158.	Sllavço Stojmensi	Vinicë
159.	Stiv Naumov	Shkup
160.	Stiv Naumov	Manastir
161.	Strasho Pinxhur	Shtip
162.	Strasho Pinxhur	Negotinë
163.	Tihomir Milloshevski	Shkup
164.	Tode Haxhi Tefov	Kavadar
165.	Todor Angellovski	Manastir
166.	Todor Janev	Veles
167.	Toli Zurdumis	Kumanovë
168.	Tosho Vellkov Pepeto	Kavadar
169.	Faik Konica	Likovë
170.	Faik Konica	Gostivar
171.	Hasan Prishtina	Shkup
172.	Hristijan Karposh	Kumanovë
173.	Hristijan Todorovski Karposh	Rankovc
174.	Hristo Uzunov	Drugovë
175.	Hristo Uzunov	Ohër
176.	Shemshovë	Jegunovc
177.	Shemshovë	Shemshovë



